


PETICIONI

51 ARTISTE KERKESE PRESIDENTIT: THUAJI "PO" NDERTIMIT TE TEATRIT TE RI

Peticionit i janë bashkuar edhe aktorët Robert Ndrenika, Luftar Paja, Alfred Trebicka, Leka Bungo, Albert Minga, Arben Derhemi etj

► FAQE 9



KESHILLI BASHKIAK


SFIDA E ERION VELIAJT: NE ZGJEDHJE TE DALE LULI, SHKELZENI, APO KUSH TE DOJE

Opozita largohet nga mbledhja e Këshillit Bashkiak pas akuzave në drejtim shumicës për projektin e Teatrit të ri

► FAQE 8

OPINION

NGA Edison Ypi



RRAHJA

Megjithse piruni s'kishte arsye ta bënte vezën të vuante, dhe vetë veza s'kishte bërë asnjë prapësi dhe dhimbjen nuk e ndjente, thuhej se veza para se të skuqet, duhet rrahur. Për ndonjërin që aspironte karrierë, pa e specifikuar pse, në ç'mënyrë, dhe me çfarë mjeti, thoshin "rreh lart".

vijon në faqen 13

[SHQIPTARJA.COM]

ÇMIMI 30 LEKË

VITI VIII - NR. 176(2389)

E PREMTE, 27-07-2018

www.shqiptarja.com

Buxheti i Shtetit

QEVERIA: NUK KA SHTESE PAGASH PER ADMINISTRATEN KETE VIT

Miratohet Akti Normativ me fuqinë e ligjit për ndryshimin e buxhetit 2018, i cili ulet me 36 milionë euro. Administrata pakësohet me 81 vetë



GENC KONDI

► FAQE 5



INTERVISTA NE REPORT TV

Shkëlqim Hajdari tregon prapaskenat e gjyqit të 21 janarit

Ish-drejtuari i prokurorisë së Apelit: Llalla s'më takoi për të diskutuar pretendencën. 21 janarin një drejtësi e re mund ta gjykojë siç duhet

► FAQE 3

VETTINGU



KOMISIONERI ANKIMON VENDIMIN POZITIV PER KRYETARIN E KUSHTETUESES

KPK-ja e konfirmoi në detyrë gjyqtarin Bashkim Dedja, ankimimi i Komisionerit vjen pas kërkesës së ONM-së

► FAQE 2

"MANDELA" I KOSOVËS

Ndahet nga jeta në moshën 82-vjeçare
Adem Demaçi

► FAQE 16



FAZA E FUNDIT

Kreditë e buta, ja familjet që kanë mundësi të blejnë shtëpi

Lista përfundimtare, si do përzgjidhen familjet përfituese dhe radha e atyre që do të marrin kredi me interes 3%

► FAQE 16

VENDIMET E KKT

Miratohet lista
e zonave me
përparësi turizmin
nga veriu në jug

► FAQE 6

Komisioneri ankimon vendimin pozitiv për Kryetarin e Kushtetueses

Komisioneri Publik pas kërkesës së Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit ankimon vendimin e KPK i cili konfirmoi në detyrë kreun e gjykatës kushtetuese Bashkim Dedja. Sipas Komisionerit Publik, Bashkim Dedja nuk arrin nivel besueshmërie në vlerësimin e pasurisë, prandaj e ka çuar çështjen në Komisionin e Pavarur të Apelit. ONM u paraqiti më 20 korrik, Komisionerëve Publikë rekomandimin për të ankimuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit për Bashkim Deden.

KOMISIONERI: PROBLEM PASURIA

Sipas komisionerit publik, Darjel Sina objekti këtij ankimi lidhet me mospërputhjet në deklarimet e pasurisë së zotit Dedja, të cilat të çojnë në konkluzionin e deklarimit të pasaktë. Nga të dhënat e disponuara thotë komisioneri Sina, konstatojmë se subjekti i rivlerësimit, nuk ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme që të paguante këstin e parë të apartamentit, në shumën 588.000 lekë. Komisioneri publik vlerëson po ashtu se subjekti është në pamjaftueshmëri financiare për blerjen e kësaj pasurie, si rrjedhojë ka kryer deklarim të pasaktë për pasurinë si dhe për detyrimet financiare në deklaratën e pasurisë në vitin 2003. Për sa i përket një tjetër pasurie të zotit Bashkim Dedja, komisioneri mbërrin në përfundimin se "se subjekti nuk paraqiti dokumentacion që të mund të vërtetoj mundësinë e aftësisë paguese të personave të tjerë të lidhur, si dhe paraqiti rrethana dhe fakte kontraktore dhe të pa sakta". Në vlerësimin e Komisionerit Publik, provat që dëshmojnë pamundësinë financiare të blinte këtë pasuri të deklaruar. Komisioneri publik shpreh kritikë për relatorin e çështjes në KPK dhe thotë: "Nga përmbajtja e vendimit ashtu dhe nga dokumentacioni i paraqitur në dosje të Komisionit, nuk rezultoi të kemi një relacion të



detajuar, hartuar nga relatori i çështjes ashtu siç e parashikon neni 44 i ligjit 84/2016". Do të jetë Kolegji i Posaçëm i Apelit që do të vendosë për fatin e mëtejshëm apo jo në detyrë të zotit Bashkim Dedja.

VENDIMI I KPK-SË

Vendimi për Bashkim Deden u dha në 13 qershor, dhe pas përfundimit të procesit, Bashkim Dedja u shpreh se procesi ishte 'si të kalosh varrin për së

gjalli'. Dosja e Bashkim Dedes përçau dhe trupën gjyquese të KPK-së, e përbërë nga Valbona Sanxhaktari, Roland Ilia dhe Xhensila Pine. Në favor të Bashkim Dedes votuan Valbona Sanxhaktari dhe Roland Ilia, ndërsa relatorja, Xhensila Pine doli kundër duke arsyetuar se Bashkim Dedja duhet të shkarkohej nga detyra.

Pasuria e Bashkim Dedes sipas Xhensila Pines ishte e dyshimtë. Në seancën e parë,

Apartamenti

Nga të dhënat e disponuara thotë komisioneri Sina, konstatojmë se subjekti i rivlerësimit, nuk ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme që të paguante këstin e parë të apartamentit, në shumën 588.000 lekë

KPK tha në 8 qershor se kreu i Kushtetueses ishte me probleme në justifikimin e pasurisë së tij, megjithëse DSIK dhe KLD deklaruan se ai plotësonte kriteret e pastërtisë së figurës dhe aftësisë profesionale. KPK hetoi pasurinë e tij dhe deklaroi se 3 apartamente të cilat përdor Bashkim Dedja ishin me burime të dyshimta e të pajustificuara. Prona e parë e dyshimtë ishte një apartament në Tiranë me sipërfaqe 146 metër katrorë dhe një garazh 15 metra katrorë, me vlerë 180 mijë euro. Në vitin 2003 Dedaj kishte deklaruar blerjen e një tjetër banese në Tiranë, ku zotëronte gjysmën e saj, ndërsa më pas kishte deklaruar se është pronar i saj 100%, pa treguar burimin e të ardhurave. Ndërkohë, dyshime



Vendimi përfundimtar KPA lë në fuqi shkarkimin e gjyqtarit Besim Trezhnjeva

Kolegji i Posaçëm i Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin e gjyqtarit të gjykatës së Durrësit, Besim Trezhnjeva. KPA ka shqyrtuar ankesën e Trezhnjevës pas shkarkimit në 13 prill nga KPK-ja. Trupa e përbërë nga Luan Daci, Ina Rama, Rezarta Schuetz, Sokol Çomo dhe e kryesuar nga Ardian Hajdari vendosi lënien në fuqi të vendimit të KPK-së. Gjyqtari Trezhnjeva largohet nga sistemi i drejtësisë pas këtij vendimi, ndërkohë që KPK gjeti nga hetimi në 3 kriteret, atë të pastërtisë së figurës, pasurisë dhe aftësive profesionale, se Trezhnjeva nuk justifikonte dot pasurinë e tij. Sipas kontrollit të Vettingut gjyqtari nuk justifikonte dot burimin e aseteve në vlerën e 20 milione lekëve si edhe burimin e tre apartamenteve, 2 në Tiranë dhe 1 në Durrës. Gjyqtari s'e pranoi vendimin duke e ankimuar pranë KPA-së, e cila siç ishte parashikuar në seancën e sotme ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të KPK-së.

për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit ngjalli dhe një banesë në Golem, ku Dedja kishte deklaruar se e kishte në përdorim, por ishte pronë e vëllait tjetër që jetonte në Dibër. KPK verifikoi dhe deklaroi se

kontrata e energjisë elektrike është paguar vetëm nga Bashkim Dedja nga dita e parë e deri më sot, duke ngjallur dyshime se kjo pronë mund të jetë e vetë gjykatësit, dhe jo e vëllait të tij që jeton në Dibër.

SEANCA / KPK: BASHKËJETUESJA S'JUSTIFIKON DOT 400 MIJË EURO

Gjyqtari Bledar Avdullai probleme me pasurinë dhe vendimet

Gjyqtari i Gjykatës së Tiranës, Bledar Avdullai, i cili është kandidat për Këshillin e Lartë Gjyqësor është përballur dje me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Në këtë seancë dëgjimore, trupa gjyquese është shprehur se Bledar Avdullai ka fshehur pasurinë si dhe ka tejkalluar afatet për gjykimin e çështjeve në disa raste.

Komisioni i Vettingut është shprehur se prindërit e Bledar Avdullait janë investitor të një fondi te një bankë e nivelit të dytë, por nuk i justifikojnë të ardhurat. Por problemet më të mëdha për gjyqtarin e Tiranës janë zbuluar te bashkëjetuesja e tij. KPK ka zbuluar se bashkëjetuesja



e gjyqtarit ka një shtëpi në Golem që nuk justifikon të ardhurat me të cilat e ka blerë. Gjithashtu bashkëjetuesja e gjyqtarit ka disa llogari në emër të saj, konkretisht 90 mijë dollar dhe 130 mijë euro dhe nuk ka burime financiare të ligjshme. Po kështu bashkëjetuesja e gjyqtarit ka prositur një apartament për të blerë në Tiranë, një zyrë dhe një garazh me vlerë totale 187 mijë euro, për të cilat gjithashtu vihet në dyshim burimi i të ardhurave. Vetë gjyqtari Bledar Avdullai tha se bashkëjetuesja e tij këto para i ka nga bizneset dhe trashëgimi nga familja, por i pyetur nga trupa gjyquese nuk e tha saktë kohën që

ka filluar të jetojë me të. Gjithashtu KPK ka konstatuar se gjyqtari i Tiranës ka liru një të burgosur të arrestuar për drogë. Gjyqtari i ka dhënë masën arrest shtëpiak, ndërkohë që apeli i Tiranës e ka rikthyer në burg këtë person. Nga kontrolli, KPK ka zbuluar gjithashtu se Bledar Avdullai ka tejkalluar afatet për disa çështje civile, duke i zgjatur ato më shumë se 1 vit e gjysëm pa arsye. Edhe në këtë rast gjyqtari është justifikuar se ka ndodhur për shkak të ngarkesës në punë. Komisioni i Vettingut pritet të japë vendimin për Bledar Avdullain në 30 korrik, ku do të vendoset nëse do shkarkohet apo do konfirmohet në detyrë.



ONM për Report Tv: Do rishikojmë dokumentacionin e Zaganjorit

KPK e konfirmoi në detyrë kreun e Gjykatës së Lartë

Numri një i Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori u rikonfirmua nga Vettingu për të vijuar detyrën dy ditë më parë. Por gjatë deklarimeve përpara trupës gjyqësore të KPK Zaganjori pranoi se kishte bërë disa kontrata fiktive që lidheshin me pasuritë e tij. Pavarësisht këtij deklarimi KPK nuk e gjeti me probleme kreun e gjykatës së lartë.

Për këtë deklarim problematik të zotit Zaganjori Report TV i drejtoi një pyetje Operacionit Ndërkombëtar të Monitorit të procesit të Vettingut. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit në përgjigjen e tyre për Report TV thonë se ata po rishikojnë dokumentacionin e dosjes Zaganjori. "Do të shikojmë disa dokumente relevante për këtë rast"-theksohet në përgjigje. Por a do të kërkojë ONM apelim pas rikonfirmimit të Zaganjorit? Nuk mund të komentojmë tani hapat e mëtejshëm. Gëzojmë të drejtën të sugjerojmë apelim sipas ligjit të Vettingut", deklaroi ONM.



Intervista në Report TV

Shkëlqim Hajdari tregon prapaskenat e gjyqit të 21 janarit

Ish-drejtuari i Prokurorisë së Apelit, tashmë kryeinspektor i Republikës, Shkëlqim Hajdari, i ftuar në "45 minuta" me gazetarin Denis Minga, ka folur për disa çështje mes tyre, hetimet për ish-kryeprokurorin Adriatik Llalla. I pyetur për aksionin e fundit të prokurorisë për vënien nën sekuestro të pronave të Llallës, Hajdari ka thënë se e ka paralajmëruar dështimin e Llallës që ditën kur ky i fundit shkeli në kryeprokurorinë e Përgjithshme. Hajdari e ka quajtur Llallën "dësh-tim spektakolar".

"Më kthyet në ato vite, 3-4 vite kur unë isha pjesë e sistemit. Unë kisha mundësi të artikulohesha, që kur erdhi u kuptua që kur erdhi zotëria, se kryeprokuroria kishte një stabilitet, me hetime profesionale, që institucioni të mos ishte i përfshirë në kapje. Ju them me bindje se personi në fjalë është një dësh-tim spektakolar, nga pikëpamja institucionale, morale dhe profesionale. Publiku e ka kuptuar se zotëria ka punuar me një klientelë për të sabotuar sistemin e drejtësisë. Kemi tentuar të mos bllokohet reforma. Reforma u finalizua në 2016, zotëria se donte reformën, ka lënë gjurmë pa fund. Dëmin e realizoi me sukses të plotë, ai i përket të shkuarës. Ai problemn e ka me drejtësinë, me kolegët dhe ish-vartësit e tij. Ky rast i paprecedentë të shër-bejë për të gjithë klasën politike shqiptare, që minimumi të zgjidhet një njeri me moral, i aftë, etj. Gjatë karrierës sime në administratë të shtetit s'kam patur asnjë përplasje me njeri. Unë i diskutoj të gjitha ngjarjet në parim. Edhe kur kam debate, parimet dhe të drejtën nuk i negocioj. Pakënaqësitë sesi erdhi Llalla për të drejtuar prokurorinë,

Ish-drejtuari i prokurorisë së Apelit: Llalla s'më takoi. Një drejtësi mund ta rigjykojë 21 janarin siç duhet

duke zëvendësuar prokurorë, me transferime të paligjshme, me klientelë, këto janë provuar e do provohen", tha ish-prokurori Shkëlqim Hajdari.

REFUZIMI I LLALLES PËR T'U TAKUAR

Hajdari ka treguar disa nga prapaskenat e hetimit të dosjes së 21 janarit. Ai tha se në kohën kur Hajdari kishte marrë në dorë dosjen e 21 janarit, ka kërkuar të takojë Adriatik Llallën asokohe i sapoardhur në detyrë. Hajdari ka thënë se Llalla nuk ka pranuar të diskutojë këtë çështje me të, duke u shmangur. "Që kur erdhi, i ofrova dorëheqjen kur isha drejtues i prokurorisë së Apelit. Kur erdhi Llalla në dhjetor të 2012, isha unë me 21 janarin. Llalla nuk ka pranuar të bisedojë me mua për 21 janarin, pavarësisht kërkesës sime për një mendim. E ka shtyrë dhe në fund unë kam shkuar pa u konsultuar me të. Siç duket ai s'ishte në gjendje për të diskutuar. Unë bëra rekurs në Gjykatën e Lartë. Ai vazhdoi sulmet, në dhjetor të 2015 unë u transferova në Shkodër. Në 2016 ka një koicidencë, u refuzua kërkesa për transferimin tim, por u refuzua



21 janari
"21 janari është një nga rekurset që unë si profesionist e kam bërë me bindje të plotë. 21 janari nuk është zbardhur dhe njerëzit nuk janë dënuar siç ndodhi. Një drejtësi e re mund ta rigjykojë siç duhet"

dhe rekursi im për gjykimin e 21 janarit", u shpreh ish-drejtuari i prokurorisë së Apelit.

RIGJYKIMI I 21 JANARIT

Hajdari, sot kryeinspektor i Republikës, ka thënë se dosja e 21 janarit është një nga çështjet më të rëndësishme që duhet rigjykuar, pasi sipas tij nuk janë dënuar fajtorët e vërtetë. "21 janari është një nga rekurset që unë si profesionist e kam bërë me bindje të plotë. 21 janari nuk është zbardhur dhe njerëzit nuk janë dënuar siç ndodhi. Një drejtësi e re mund ta rigjykojë siç duhet", theksoi Hajdari.

RIGJYKIMI I DOSJEVE TË MBYLLURA

Ish-drejtuari i prokurorisë së Apelit ka folur edhe për çështjen e rigjyimit të dosjeve të mbyllura. Ai ka thënë se është pro rigjykimin, pasi sipas tij, çdo çështje që ka një provë të re, vlen të rigjykojë. "Në parim, çdo çështje që del provë e re, s'ka asnjë pengesë për t'u hapur. Ka vrasje, çështje të njerëzve të zakonshëm, vrasje që janë bërë të mirëorganizuar. Besoj që Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Prokuroria e Posaçme

të rihapin dosje të vjetra", sqaron kryeinspektor i Republikës.

I pyetur nga gazetari Denis Minga, se a mbyllet "dënimi" i gjyqtarëve dhe prokurorëve të skualifikuar nga Vettingu vetëm me shkarkimin e tyre nga detyra, Hajdari ka thënë se për çdo gjyqtarë që ka të dhëna korruptive, mund të dërgohet informacioni në prokurori. "Njëherë duhet të sqarojmë opinionin që dërgimi i materialeve në prokurori s'ka lidhje me Vettingun. Këto institucione mund të dërgojnë të dhëna në prokurori. Llalla ishte një nga zyrtarët e parë që ishte planifikuar të hetohej nga KPK. Procedurë normale hetimi. Edhe të tjerë prokurorë e gjyqtarë që skualifikohen nga Vettingu, mund të hetohen", thotë Shkëlqim Hajdari.

Për vakancat e krijuara në sistemin e drejtësisë, Hajdari ka thënë se situata e krijuar s'ka qenë e parashikuar në 2016, kur kaloi reforma. Hajdari është shprehur se ka besim se në shtator, parlamenti do të kalojë ligjin për magistratët duke i dhënë mundësi plotësisht të vendeve bosh në sistem, që sipas tij, pas dy vitesh mund të kapin shifrën e 200 prokurorëve dhe gjyqtarëve të larguar. "Kjo situatë që ka ndodhur në Shqipëri, nuk ka qenë parashikuar. As mendjet më të sofistikuar s'mendonin se do kishte kryeprokurorë të përkohshëm. Situata është e rëndë, por ka rrugëzgjdhje. Politika shqiptare t'i japë rrugëzgjdhje. Kemi prononcime të forta të BE, OPDAT dhe SHBA që magistrat që mbaruan shkollën dhe ligji për emërimin të kalojë. Besoj se kjo pjesë do riparohet. Pas 2 vitesh sistemi do ketë 200 gjyqtarë e prokurorë më pak. Do kemi sistemin bosh", ka deklaruar Shkëlqim Hajdari, ish-drejtuari i prokurorisë së Apelit.

Akuzat e PD për Vettingun, Balla KPK-ja e pavarur

Kryetari i grupit parlamentar takim me deputeti gjerman, Lobel: Shqipëria e ka marrë shumë seriozisht me Reformën në Drejtësi, por edhe ne

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla ka zhvilluar një takim me deputetin gjerman, Nikolas Lobel. Në një konferencë të përbashkët për mediat, nga kryesia e Kuvendit, Balla dhe Lobel folën për procesin e negociatave të Shqipërisë me BE-në. Balla siguroi Lobel se do të vijojë puna për plotësimin e kushteve dhe për të arritur progresin e kërkuar nga BE. "Do vazhdojmë luftën kundër krimit të organizuar. Folëm për vettingun, ligjin për magistratët dhe bojkotin e opozitës. Do të punojmë për ngritjen e institucioneve të reja të drejtë-

sisë. Me sfida dhe vështirësi do të vijojmë punën për reformën në drejtësi. Falenderoj bundestagun për mbështetjen", theksoi Taulant Balla. Deputeti Lobel nga ana tjetër, ritheksioi edhe njëherë qëndrimin mbështetës të qeverisë gjermane, por tha se përveç Gjermanisë, Shqipëria ka shumë punë me vendet e tjera të BE-së, të cilat duhet të binden për progresin e Shqipërisë. "Evropa është një bindje dhe për të krijuar këtë bindje s' duhet bindur vetëm Gjermania por edhe vende të tjera. Në pranverën e vitit 2019 do të jetë parlamenti evropian që do të paraqesë një progres raport, dhe në bazë të tij do të jepet vendimi për Shqipërinë.

DEPUTETI GJERMAN

"Po punojmë me qeverinë dhe kryeministrin Edi Rama. Po punojmë me ekspertët, por duhet punë e madhe. Shqipëria e ka marrë shumë seriozisht me Reformën në Drejtësi, por edhe ne."

Ky është fillimi i procesit dhe i bisedimeve për anëtarësimin në BE. Mjafton të marrësh në konsideratë opinionin e qytetarëve shqiptarë që duan mbi 92% e tyre të jenë pjesë e familjes evropiane. Viti 2019 është i rëndësishëm për Shqipërinë, po punojmë së bashku. Vit i mbushur me sfida, po punojmë me qeverinë dhe kryeministrin Edi Rama.



"MAGJISTRATET"

"Në seancën më të parë në 3 shtator, pasi dielli dhe vera të kenë ndikuar në mendjet e opozitës, detyra e parë që na pret është që të miratojmë ligjin për magistratët", tha Balla

për magistratët. "Në seancën më të parë në 3 shtator, pasi dielli dhe vera të kenë ndikuar në mendjet e opozitës, detyra e parë që na pret është që të miratojmë ligjin për magistratët", u shpreh Balla Nikolas Lobel i cili është përgjegjës për Ballkanin në Komisionin e Politikës së Jashtme të Bundestagut, nuk u shpreh i shqetësuar për faktin se vendi aktualisht nuk ka gjykatat më të larta. Pyetjes së Report TV nëse kjo gjendje është një rrezik për demokracinë, Lobel ju përgjigj: "Në shtetin e së drejtës reformat marrin kohën e tyre dhe ndonjëherë zgjasin shumë. Reforma në drejtësi dhe institucionet e saj janë shtyllë e demokracisë dhe ndonjëherë, mbase reformat janë të gjata e të thella. Por një shtet demokratik duhet të ketë edhe institucione dhe instrumente që të funksionojë e të jetë një shtet i së drejtës funksionuese". Deputeti gjerman përsëriti vëmendjen e shtetit të tij për një reformë zgjedhore të plotë e të qëndrueshme.

TITULLI / AMBASADORJA E BE SHPALLET "QYTETAR NDERI I VLORËS"

Demokratët e Vlorës kundër linjës së partisë, nderojnë Vlahutin

Ka kohë që ambasadorja e BE, Romana Vlahutin është vënë në shënjestër të kritikave nga ana e drejtuesve të Partisë Demokratike që e cilësojnë atë si një përkrahëse të kryeministrit Edi Rama. Akuzat kanë qenë të shumta si publike nga eksponentë të PD-së e deri edhe nëpërmjet shkrimeve në media të opozitës. E megjithatë duket se këshilltarët e PD-së në Bashkinë e Vlorës nuk ndajnë të njëjtin mendim me krerët në Tiranë. Ata dje kanë votuar në mënyrë unanime një propozim për nderimin e Vlahutin nga kjo bashki. Në Bashkinë e Vlorës një nga



pikat e rendit të ditës ka qenë edhe miratimi për dhënien e titullit "Qytetar nderi i Vlorës" për ambasadorën e BE-së në Shqipëri, Romana Vlahutin. Kryetari i Bashkisë, Dritan Leli ka kërkuar votimin në unanimitet për këtë vendim, lidhur me një nga figurat siç e ka cilësuar Leli, më të rëndësishme për Shqipërinë dhe Vlorën. "Kam qenë unë propozuesi i këtij vendimi", - ka thënë Leli, - "Sepse e konsideroj personalitetin më të spikatur që ka lënë gjurmë në politikën shqiptare, por mbi të gjitha që ka lënë gjurmë në ato ç'ka janë investuar në Vlorë nga delegacioni i BE-së në Shqipëri,

veçanërisht për ndërtimin e shëtitores "Lungomare". Këshilltarët Bashkiakë, e kanë votuar në mënyrë unanime këtë vendim, ndërsa tani pritet dhënia e titullit të akorduar. "Report TV

ka mësuar se kanë votuar pro vendimit edhe këshilltarët e Partisë Demokratike. Ndërkohë në mbledhjen e kësaj të enjteje Këshilli Bashkiak i Vlorës ka miratuar edhe një sërë vendimesh të tjera

për të cilat nuk kanë munguar edhe kontestime. Është miratuar fondit shtesë prej 3,5 milion lekë, subvencion për ekipin e futbollit "Oriku", miratimi i shtyrjes së afatit në një periudhë 2 vjeçare

të administrimit të shoqërisë "Flamurtari futbolli klub", miratimin për tarifimin e vizitorëve në gadishullin e Karaburunit me 200 lekë për person.

NE REPORT TV

Hyseni: Brenda një viti ngrihen organet e reja të drejtësisë

Deputeti PS kërkon mirëkuptim e durim nga qytetarët



Partia Socialiste parashikon që brenda një viti të gjitha organet e reja të drejtësisë do të jenë ngritur dhe sistemi do të funksionojë normalisht. Anëtarë i Komisionit të Ligjeve, Alket Hyseni gjatë një intervistë për Report TV kërkon mirëkuptim e durim nga qytetarët për përfundimin e procesit të Vettingut. "Le t'i japin kohë kësaj reforme. Njerëzit kanë duruar me padrejtësi 27 vjet, jo më për një vit. Unë mendoj që maksimumi i durimit edhe një vit do të jetë. Institucionet e vettingut do të mbarojnë vettingun e listës prioritare. Në harkun e një viti kohor nga sot, institucionet e reja të drejtësisë do të jenë krijuar", shpreh Hyseni. Deputeti socialist ju bën thirrje qytetarëve që mendojnë se ju është bërë padrejtësi me gjyqet, të bashkëpunojnë me organet e vettingut si e vetmja mënyrë për të pasur shansin të rihapin dosjet e tyre. "Vettingu nuk duhet të mjaftohet

vetëm me nxjerrjen jashtë sistemit. Unë mendoj që për ato raste kur ka prova, dëshmi, për korrupsion, vetë institucionet e vettingut duhet të bëjnë kallëzim penal e të përcjellin në prokurori rastet. Për të kaluar në një moment të dytë, siç është dhënia e një dënimi penal për këdo që ka shkelur ligjin, dënim i cili do të përdorej si element për të rifilluar çështjen gjyqësore për të gjitha ato raste ku ka prova të qarta se është devijuar vendim-marrja për shkak të korrupsionit. Kjo shërben edhe si thirrje për të gjithë qytetarët: Ndihejmon procesin e vettingut me prova, fakte, informacione të sakta, dëshmitarë konkretë, duke çuar dokumente për rastet gjyqësore që ju është bërë drejtësi", thotë Hyseni.

OPOZITA

Deputeti i PS-së pyetjes se a po i konsideron mazhoranca 7 kushtet e Lulzim Bashës I përgjigjet se:

"Unë zotit Basha do t'i sugjeroja që me numrin 7 të bëjë kujdes sepse bën gjithnjë gafa. Opozita çdo ditë nxjerr pretekste të paqena për të bllokuar reformën. Kushtet Basha t'i shumëzoi 7 me 7 e t'i dalin 42 sa i dalin përherë, por të vijë e të ulet me mazhorancën dhe me segmente të tjera të opozitës dhe të gjejmë zgjidhje teknike për të zgjidhur më shpejt disa problemeve të momentit, pasi më pas sistemi ka parashikuar zgjidhje vetvetui pas një viti kur të ngrihen institucionet e reja. Presioni juaj si media dhe presioni i publikut duhet të shkojë tek ata aktorë politikë të cilët po e bllokjnë reformën. Duket qartë që nuk kanë vullnet. Synimin e kanë tek bllokimi i reformës. Publiku të tregojë me gisht ata që janë penguesit realë të kësaj reforme, që shkaktojnë këtë ngerc të madh. Me presionin popullor ata do të vijnë të votojnë ato ligje që duhen", shpreh Alket Hyseni.

SHPALLE ANKANDI

Shoqëria Përmbartimore "616/A" shpall për shitje në ankandin e tretë pasurinë e paluajtshme të debitorit Kastriot Tahiri Llapit & Aneta Kristaq Llapit të llojit Apartament banimi me nr. pasurie 15/19+3-33, vol.2, faqe nr.79, z.k. 8541, e ndodhur në Gjirokastër. Pasuria shpallet për shitje me Vlerë fillestare 1.953.836.7 lekë (Njëmilion e nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë pikë shtatë) lekë.

Ankandi zhvillohet ditën e enjte në datë 23 Gusht 2018

Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagjia Nr.3, Rruga "Andon Xoxe", Pogradec ose të kontaktojnë ; Cel:0682223020, e-mail: shoqer ia616a@gmail.com

GENC KONDI
TIRANE

Buxheti i Shtetit ulet me 36 milionë euro me rregullimet e mesvitet. Përveç kësaj, do të pakësohet numri i punonjësve të administratës me 81 vetë, ndërkohë që anulohet rritja e mundshme e pagave të nepunësve shtetërore, që ishte parashikuar nga një nen i veçantë në ligjin aktual për Buxhetin 2018, në masën 1 miliard lekë.

Këto, dhe të tjera, janë ndryshime që janë bërë dhe në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, sipas propozimit të ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Sipas traditës, shifrat e Buxhetit iu nënshtrohen ndryshimeve në gjysmën e parë të vitit, këtë herë kryesisht në ulje.

BILANCI

Në ligjin për Buxhetin e vitit 2018, që është miratuar në fund të vitit të kaluar, përcaktohej niveli prej 357 miliardë e 853 milionë lekësh si të ardhura në Buxhetin e Shtetit. Kjo shifër aktualisht korrigjohet në ulje, duke qenë se qeveria ka vendosur ta kalojë atë në 353 miliardë e 354 milionë lekë, me një ulje në masën gati 4.5 miliardë lekë apo gati 36 milionë euro.

Muajt e fundit, ndonëse niveli i të ardhurave ka qenë vazhdimisht më i lartë se ai i realizuar vitin e kaluar, gjithsesi është konstatuar një ngadalësim i kësaj rritjeje, ndërkohë që shifrat e planit si gjashtëmujor në këtë drejtim nuk janë realizuar. Me sa duket, Financat publike e kanë marrë në konsideratë një trend të tillë, duke u treguar më realiste për performancën e institucioneve në vartësi të tyre.

Nga ana tjetër, në ulje parashikohet tanimë edhe zëri i shpenzimeve në Buxhetin e Shtetit. Konkretisht, nga 390 miliardë e 219 milionë lekë që janë parashikuar në ligj, me Aktin e djeshëm Normativ kjo shifër kalon në nivelin e 385 miliardë e 720 milionë lekëve, një ulje prej 4.5 miliardë lekësh, bazuar edhe kjo në uljen e të ardhurave, për të mos rritur borxhin publik. Në fakt, si pasojë e kësaj ri-llogaritjeje, deficitit buxhetor do të mbetet i njëjtë: 32.37 miliardë lekë,

Qeveria: Nuk ka shtesë pagash për administratën këtë vit, pakësohen 81 vetë

Miratohet Akti Normativ me fuqinë e ligjit për ndryshimin e buxhetit 2018



sa ç'parashikon edhe Ligji aktual.

PAGAT

Por, në kuadër të uljes së shpenzimeve buxhetore, përfshihet edhe një klauzolë: shfuqizohet Neni 14 i ligjit aktual, i cili thotë se "Fondi për rritjen e pagave prej 1.000 milionë

lekësh shpërndahet nga Ministria e Financave mbi bazën e nivelit të pagave që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave". Anulimi i këtij Neni nënkupton se këtë vit nuk duhet të ketë rritje të pagave të administratës. Kjo ishte një gjë që pritej, pasi zakonisht një rritje e

tillë vendoset që në gjashtëmujorin e parë të vitit dhe hyn në fuqi më 1 korrik, gjë që nuk ka ndodhur.

PUNONJËSIT

Nga ana tjetër, edhe numri i punonjësve të administratës ndryshon, gjithashtu në ulje. Nga 81 mijë e 753 vetë, ai kalon sipas Aktit Normativ në 81 mijë e 672 vetë. Ulje minimale, prej 81 personash, por gjithsesi që largon disa dhjetëra vetë nga puna në shtet.

VENDORËT

Në një lëvizje të kundërt me sa më sipër, bashkëve u parashikohet një rritje e vogël e të ardhurave, që kalojnë, nga një total prej 46 miliardë e 188 milionë lekësh, në 46 miliardë e 221 milionë lekë. Pritej që, në prag të zgjedhjeve vendore të vitit të ardhshëm, qeveria mund të bënte edhe më shumë në këtë drejtim.

REZERVA

Si gjithnjë, në buxhetin e shtetit parashikohet edhe një rezervë, që shfrytëzohet në raste jo të zakonshme shpenzimesh. Ajo përbëhet nga Fondi Rezervë, që menaxhohet nga Këshilli i Ministrave, si dhe nga Kontigjenca. Ndërsa kjo e fundit – që përdoret kryesisht për t'u mbrojtur nga luhajtje në kursin e këmbimit valutor apo lëvizje në normat e interesit të



Detajet

PERFORMANCA

Muajt e fundit, ndonëse niveli i të ardhurave ka qenë vazhdimisht më i lartë se ai i realizuar vitin e kaluar, është konstatuar ngadalësim i kësaj rritjeje, ndërkohë që shifrat e planit si gjashtëmujor s'janë realizuar

PENSIONET

Fondi i sigurimeve shoqërore, ku boshti kryesor përbëhet nga pensionet e më se 600 mijë shqiptarëve, kalon në 122 miliardë e 276 milionë lekë, me një rritje në masën 16 milionë euro mbi parashikimin aktual

borxhit - nuk lëviz nga 4 miliardëshi i miratuar në fund të vitit të kaluar nga Kuvendi i Shqipërisë, Fondi Rezervë ndryshon. Edhe ky në ulje. Kështu, nga 2.7 miliardë lekë, qeveria do të ketë në dispozicion për raste të jashtëzakonshme 2.6 miliardë; 100 milionë lekë më pak. Në këtë kuadër, 200 milionë lekë më pak do të kenë institucionet e reja të Drejtësisë (nga 1 miliard, shifra kalon në 800 milionë lekë), ndërsa me 100 milionë lekë rriten fondet për ngjarje të papritura, që kalojnë nga 1.7 në 1.8 miliardë lekë.

SIGURIMET

Sa u përket fondeve të detyrueshme të sigurimeve sociale, fondi në dispozicion të sigurimeve shëndetësore mbetet i pandryshuar, me 40 miliardë e 400 milionë lekë. Ndërsa ai i sigurimeve shoqërore, ku boshti kryesor përbëhet nga pensionet e më se 600 mijë shqiptarëve, kalon në 122 miliardë e 276 milionë lekë, nga 120 miliardë e 251 milionë lekë, me një rritje në masën 16 milionë euro.

Statistikat
TIRANE

Ndonëse rritja ekonomike i ka kaluar 4% në tre muajt e parë të vitit, kjo nuk po shoqërohet me një performancë pozitive të të ardhurave buxhetore. Sipas statistikave fiskale të publikuara nga Ministria e Financave, të ardhurat buxhetore për 6 mujorin arritën në 216.9 miliardë lekë, me një zgjerim prej vetëm 2.2% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Duke pasur parasysh që rritja ekonomike në tre muajt e parë të vitit arriti në 4.45%, ndërsa inflacioni u përshpejtua në 2.4%, rritja reale e të ardhurave rezultoi negative prej -4.65%.

Në raport me atë që ishte planifikuar në fillim të vitit,

Si 6-mujor, buxhetit i munguan 60 milionë euro nga plani

Mosrealizimet bëhen shkak për shkurtimet në të ardhura dhe në shpenzime

të ardhurat janë 7.5 miliardë lekë, ose rreth 60 milionë euro më pak, duke shënuar performancën më të dobët buxhetore që prej vitit 2013, kohë kur u ndryshuan qeveritë.

Të ardhurat nga tatimet e doganat u rritën vetëm me 1.6%, në 145.5 miliardë lekë, duke pasur dhe mosrealizimin më të madh ndaj planit, me 7.8 miliardë lekë. Mosrealizimi më i madh ishte tek TVSH, që është një treg-

ues direkt i qarkullimit në ekonomi (-4 miliardë lekë), tatim fitimi (1 miliardë lekë),

akciza (1.2 miliardë lekë) dhe tatimi mbi të ardhurat personale (1 miliardë lekë). Financat

kanë fajësuar më herët edhe efektin e kursit të këmbimit (zhvlerësimi i euros) nga i

cili buxheti ka humbur 3.6 miliardë lekë në 5 muajt e parë të vitit. (Monitor)



SHPALLJE ANKANDI

SHOQËRIA PËRMBARIMORE "CORRECTOR" SHPK, ZHVILLON ANKANDIN E III-TË, PËR SHITJEN E PASURISË SË PALUAJTSHME,

Ankandi zhvillohet dt. 03/08/2018, në adresën, Rruga e Kavajes, Ndertesa 27, Hyrja 1, Kati i III -te, Tiranë.

- Apartament me sipërfaqe 113.2 m², me Nr.Pasurie 24/240+1-8, Vol.28, Fq.75, ZK 8603, ndodhur në Vlorë, regjistruar në pronësi të Gentian Binaj, pranë ZVRPP Vlorë.

Cmimi i ankandit të tretë është EUR 28,728 (njëzetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzetë e tetë euro);

Miratohet lista e zonave me përparësi turizmin nga veriu në jug

KKT merr vendime edhe për ndërtimin e tetë hidrocentraleve të rinj vendorë



Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar dhe shpallur dje zonat me përparësi zhvillimin e turizmit në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. KKT ka zhvilluar dje mbledhjen e radhës duke miratuar një numër rekord vendimesh: 28 të tillë.

TURIZMI

Do të jenë 16 zonat me përparësi turizmin. Në të cilat përfshihet, në radhë të parë, i gjithë brezi bregdetar nga veriu në jug. Por edhe liqene, zona malore, etj.

Sa më poshtë vijon lista e tyre: Brezi bregdetar, Parku natyror i Alpeve, Parku natyror Korab-Koritnik, Belshi, Liqenet e Ohrit dhe Prespës, Liqeni i Shkodrës, Liqeni i Ulzës, Lugina e Vjosës-Zagoria, Parku natyror Lurë-Dejë, Dajt-Bizë-Martanesh-Krastë, Mali i Tomorrit, Kanionet e Osunit, Nivica, Shebenik-Jabllanicë, Vargmali i Moravës dhe Zona e Rinasit.

Në përputhje me legjislacionin përkatës, këto zona të të kenë përparësi në ndihmën nga shteti me infrastrukturë, furnizim me energji, investime, etj.

Nga ana tjetër, janë përcaktuar edhe plane për zona me rëndësi kombëtare: Plani për Zonën me Rëndësi Kombëtare mes Lagunës së Karavastës dhe lumit Seman, si dhe është marrë vendimi për hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare Drilon-Tushemisht.

Ndërkohë, gjithnjë me objektiv turizmin, është dhënë leja për ri-

ZONAT PRIORITARE PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT

Brezi bregdetar
Parku natyror i Alpeve
Parku natyror Korab-Koritnik
Belshi
Liqenet e Ohrit dhe Prespës
Liqeni i Shkodrës
Liqeni i Ulzës
Lugina e Vjosës-Zagoria
Parku natyror Lurë-Dejë
Dajt-Bizë-Martanesh-Krastë
Mali i Tomorrit
Kanionet e Osunit
Nivica
Shebenik-Jabllanicë
Vargmali i Moravës
Zona e Rinasit

kualifikimin në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë, restaurimin e monumenteve të kulturës dhe rikonstrukcion i objekteve të tjerë ekzistues, si dhe ajo për rikualifikimin e bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës, rikualifikimi i qendrës së Shirokës dhe restaurimi i fasadave

ekzistuese Shirokë.

ENERGJIA

Sa u përket investimeve nga ndërmarrje publike për energjinë elektrike, janë dhënë disa leje. Konkretisht: Leje Ndërtimi për objektin: "Nënstacion 110/35/20 kV Arras dhe linjë elektrike 110 kV", Bashkia Dibër"; Leje Ndërtimi për objektin: "Rrjeti shpërndarës 20 kv nga Nënstacioni 110/20 kv Fieri i Ri Fiderat 10 deri 12 dhe Nënstacioni 110/20 kv Fieri 2 Fiderat M1 deri M10, në Bashkinë Fier"; Leje Ndërtimi për objektin: "Ndërtimi i dy fiderave të ri kabllorë fideri F9 dhe fideri F10 me izolacion 20kv, kabinat, rrjeti TU me kabllorë me vetëmbajtje ABC nga Nënstacioni" dhe Leje Ndërtimi për objektin: "Zgjerimi i rrjetit 20kv në Vrrinë, me kabina të reja dhe rrjet TU" në Bashkinë Durrës.

Sa u përket investimeve private, janë dhënë leje ndërtimi për tetë hidrocentrale, konkretisht hidrocentrali "Plepi", në përroin e Plepit, komuna Oshun, Bashkia Bulqizë; "MIVAS", në pellgun ujëmbledhës të lumit të Tomorricës, Bashkia Gramsh dhe Bashkia Skrapar; "MIVAS 1", me vendndodhje në ujrat e lumit të Tomorricës, degë e lumit Devoll, Bashkia Skrapar; "Polemi", në pellgun ujëmbledhës mbi tre degëzimet e përroit të Neshtës, degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd; "Vardari", në përroin e Vardarit dhe të Valit, degë e përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd; "Thanza", në ujrat e përroit të Kalimashit, i cili derdhet në Liqenin e Fierzës, Bashkia Kukës; "Prevalli", në përroin e Zallit

Vendimet e miratuara në KKT

1. Master-Plani Kombëtar për Sektorin e Gazit
2. Plani për Zonën me Rëndësi Kombëtare mes Lagunës së Karavastës dhe lumit Seman
3. Nisma për hartimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare Drilon-Tushemisht
4. Leje Zhvillimi për zonën e Bulevardit, Parkut Qendror dhe Lumit të Tiranës
5. Leje Zhvillimi për objektin: "Kompleks i Ri Rezidencial i Stafit Diplomatik të Ambasadës së Kuvajtit"
6. Leje Ndërtimi për objektin: "Ndërtimi i Urës së Drojës", Thumanë
7. Leje Ndërtimi për objektin: "Nënstacion 110/35/20 kV Arras dhe linjë elektrike 110 kV", Bashkia Dibër"
8. Leje Ndërtimi për objektin: "Rrjeti shpërndarës 20 kv nga Nënstacioni 110/20 kv Fieri i Ri Fiderat 10 deri 12 dhe Nënstacioni 110/20 kv Fieri 2 Fiderat M1 deri M10, në Bashkinë Fier"
9. Leje Ndërtimi për objektin: "Ndërtimi i dy fiderave të ri kabllorë fideri F9 dhe fideri F10 me izolacion 20kv, kabinat, rrjeti TU me kabllorë me vetëmbajtje ABC nga Nënstacioni"
10. Leje Ndërtimi për objektin: "Zgjerimi i rrjetit 20kv në Vrrinë, me kabina të reja dhe rrjet TU" në Bashkinë Durrës
11. Leje Zhvillimi për rikualifikimin në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë, restaurimin e monumenteve të kulturës dhe rikonstrukcion i objekteve të tjerë ekzistues
12. Leje Zhvillimi për rikualifikimin e bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës, rikualifikimi i qendrës së Shirokës dhe restaurimi i fasadave ekzistuese Shirokë
13. Leje Ndërtimi për objektin: "Rikonstrukcion i Godinës së ish Kirurgjisë, në Qendrën Spitalore "Xhaferr Kongoli", Bashkia Elbasan"
14. Leje Ndërtimi për objektin: "Estakada me tunelin që lidh Repartin e Kirurgjisë së Vjetër me Repartin e Kirurgjisë së re", në Qendrën Spitalore "Xhaferr Kongoli" Elbasan
15. Leje Ndërtimi për objektin: "Rikualifikimi i ndërtesave të Universitetit Politeknik të Tiranës"
16. Leje Ndërtimi për objektin: "Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit "Plepi", në përroin e Plepit, komuna Oshun, Bashkia Bulqizë
17. Leje Ndërtimi për objektin: "Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit "MIVAS", në pellgun ujëmbledhës të lumit të Tomorricës, Bashkia Gramsh dhe Bashkia Skrapar"
18. Leje Ndërtimi për objektin: "Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit "MIVAS 1", me vendndodhje në ujrat e lumit të Tomorricës, degë e lumit Devoll, Bashkia Skrapar
19. Leje Ndërtimi për objektin: "Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit "Polemi", në pellgun ujëmbledhës mbi tre degëzimet e përroit të Neshtës, degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd
20. Leje Ndërtimi për objektin: "Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit "Vardari", në përroin e Vardarit dhe të Valit, degë e përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd
21. Leje Ndërtimi për objektin: "Ndërtimi i Hec "Thanza", në ujrat e përroit të Kalimashit, i cili derdhet në Liqenin e Fierzës, Bashkia Kukës
22. Leje Ndërtimi për objektin: "Ndërtimi i Hec Prevalli, në përroin e Zallit të Kostenjës, degë e zallit të Lunikut me derdhje në lumin Shkumbin, fshati Prevalli, Bashkia Librazhd"
23. Leje Ndërtimi për objektin: "Ndërtimin e hidrocentraleve "Kaçinar", me vendndodhje në lumin Shpërdhazë, komuna Kaçinar, Bashkia Mirditë"
24. Leje për ndryshim projekti gjatë ndërtimit për objektin: "Ndërtimi i Portit MBM, me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës"

të Kostenjës, degë e zallit të Lunikut me derdhje në lumin Shkumbin, fshati Prevall, Bashkia Librazhd dhe "Kaçinar", me vendndodhje në lumin Shpërdhazë, komuna Kaçinar, Bashkia Mirditë.

OBJEKTET

Janë dhënë leje Zhvillimi edhe

për zonën e Bulevardit, Parkut Qendror dhe Lumit të Tiranës dhe leje ndërtimi për Urën e Drojës në Thumanë. Leje për ndryshim projekti gjatë ndërtimit është dhënë nga Këshilli Kombëtar i Territorit edhe për objektin: "Ndërtimi i Portit MBM, me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës".

Kreditë e buta, ja familjet që kanë mundësi të blejnë shtëpi

Lista përfundimtare, si do përzgjidhen familjet dhe radha e atyre që do të marrin kredi me interes 3%

Kur pritet lista përfundimtare e fituesve për kreditë e buta, Bashkia e Tiranës publikon kriteret se si do të përzgjidhet çdo person, i cili kërkon të blejë shtëpi, duke marrë kredi me interes 3%. "Shqiptarja.com" sjell sot të plota kategoritë e familjeve dhe personave që do të jenë në krye të listës për të përfituar kredi si dhe dokumentet shtesë që iu duhen në çdo rast.

PËRFITUESIT

Po cilat do të jetë kategoritë parësore të cilat do të përfitojnë nga programi i strehimit? Familjet, ku kryefamiljari është grua e ve ose e divorcuar. Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë. Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesit shoqëror. Individët me aftësi të kufizuar, të cilët gëzojnë statusin e të verbrit të grupit të parë, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të invalidit të punës dhe të invalidit të Luftës Nacionalçlirimtare. Familjet me shumë fëmijë. Çiftet e reja me moshë totale deri në 55 vjeç.

Familjet që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi. Individët me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga jetimoret, ose nga qendrat e përkujdesit e deri në moshën 30 vjeç. Familjet të cilat vërtetojnë se nuk kanë përfituar nga Ligji nr. 7652 datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore". Gjithashtu bashkia ka parashikuar edhe familjet të cilat do të përfitojnë bonus strehimi nëse janë në njërin nga familjet emergjente.

Në këtë grup përfshihen: Familjet të cilat kanë mbetur të pastreha si rezultat i fatkeqësive natyrore dhe përfshirja e tyre në këtë iniciativë. Familjet që janë në skemën e ndihmës ekonomike si dhe grupeve të tjera të marxhinalizuara që rezultojnë si të pastrehë dhe përfshirja e tyre në këtë iniciativë. Familjet që rrezikojnë të mbeten të pastreha si rezultat i kushteve të vështira higjienosanitare, si dhe kushteve të papërshtatshme të banesës dhe përfshirja e tyre në këtë iniciativë.

PIKËZIMI DHE TË ARDHURAT

Në sistemin e pikëve që ka miratuar bashkia në udhëzimin për ndarjen e kredive, sipas statusit familjar dhe kushteve aktuale të banimit, më tepër mundësi për të përfituar paratë do të kenë familjet që banojnë në shtëpi me ish-pronarë, ndërsa jo pak shanse u jepet edhe çiftet e reja me moshë totale nën 55 vjeç. Por, në kategorizimin që është bërë nga komisioni përgjegjës, me fat do të jenë ata individë apo familje që përfshihen në më tepër se një nga grupimet e mëposhtme, pasi do të llogariten pikët e mbledhura.

– Familje që banojnë në shtëpi me ish-pronarë 20 pikë

– Familje që kanë humbur shtëpitë në firmat piramidale 15 pikë

– Familje që bëhen të pastrehë (shembje banese informale, lirim objektsh me funksione publike), për shkak të zbatimit të projekteve publike e ndërtimit të veprave me interes publik. 15 pikë

– Çiftet e reja në moshë mesatare totale deri në 55 vjeç. 15 pikë

– Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga jetimoret ose nga qendrat e përkujdesit e deri në moshën 30 vjeç. 10 pikë

DOKUMENTAT SHITESË

1. Formulari i Strehimit i plotësuar pranë njësisë administrative në të cilën aplikanti ka vendbanimin.

2. Certifikata e lindjes e aplikantit dhe certifikata e gjendjes familjare.

3. Vërtetimi i vendbanimit në bashkinë ku kërkohet vendstrehimi ose leje banimi për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit.

4. Vërtetimi i të ardhurave neto të familjes/individit.

5. Dokumenti përkatës nga punëdhënësi (vërtetim punësimi), për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit dhe të personave të tjerë të familjes që janë në marrëdhënie pune.

6. Dokumenti nga organet tatimore dhe nga sigurimet shoqërore për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë anëtarët e punësuar në familje.

7. Vërtetimi nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të qeverisjes vendore për anëtarë, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar.

8. Vërtetimi nga zyra e punës e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë.

9. Vërtetimi nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

10. Dokumenti zyrtar i celebrimit dhe certifikatat personale, për efekt të llogaritjes së moshës, për çiftet e reja.

11. Vërtetimi nga ZRPP se familja apo ndonjë anëtar i saj nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis që mund të përdoret si e tillë.

12. Vërtetimi nga ZRPP për sipërfaqen e pronës që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi për strehim.

13. Vërtetimi nga ZRPP të origjinës se nuk figurojnë e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për familjet që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi, për të gjithë anëtarët e familjes.

14. Vendimi i Gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara, shoqëruar me vërtetimin nga zyra e përmbarimit për masën e pensionit që përfitojnë për fëmijët.

15. Vërtetimi përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit.

16. Vërtetimi nga Komisioni Mjekësor për përcaktimin e Aftësisë së Kufizuar, për individë me aftësi të kufizuar.

17. Dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", "punëtor emigrant" dhe azilkërkues.

18. Dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Policisë së Burgjeve etj.

19. Dokumenti i lëshuar nga institucionet përkatëse për viktimat e dhunës në familje. Urdhri i Mbrojtjes i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, seksioni familjar (fotokopje e njehsuar me origjinalin). Vërtetim nga strukturat e shërbimit social, qendrave sociale dhe rehabilitimit për viktimat e dhunës pranë njësive të qeverisjes vendore.

20. Deklaratë noteriale që lëshohet nga kryefamiljari që shprehet se është dakord që kredia të lëvrohet për aplikantin që rezultoi i përfshirë në Formularin e Strehimit.



– Familjet me shumë fëmijë (me më shumë se dy fëmijë). 10 pikë

– Individët, të cilët gëzojnë statusin e të verbrit të grupit të parë; invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik; të invalidit të punës; të invalidit të LANÇ-it dhe statusin e veteranëve të luftës. 5 pikë

Qytetarët që përfitojnë në kreditim të lehtësuar, sipas strukturës së familjes, përcaktohen nga zyrat përkatëse në bashki dhe miratohen nga këshilli bashkiak. Për përcaktimin e kufijve minimalë dhe maksimalë, zyrat përkatëse në bashki bazohen në vlerën e banesës së ndërtuar ose të blerë në treg si dhe në aftësinë paguese të familjes. Nivel i pranueshëm merret pagesa e kësteve mujore të kredisë, e cila nuk duhet t'i kalojë 35 për qind të të ardhurave

të familjes.

Të ardhurat e familjes, pas pagesës së kësteve të kredisë, nuk duhet të bien më poshtë se niveli i plotë i ndihmës ekonomike të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj deklaroi të dielën se në shkurt do të rifillojë programi i kredisë së butë për vitin 2018 dhe të gjitha çiftet e reja mund të aplikojnë për të qenë pjesë përfitues. Veliaj tha se programi për kreditë e buta për strehim tregoi se Bashkia e Tiranës funksionon më mirë sesa operatorët privatë, duke i ardhur në ndihmë jo pak, por 1 mijë familjeve të reja dhe në nevojë, që nuk kishin mundësi të përballonin interesat e tregut për të blerë shtëpinë e tyre.

Sfida e Veliajt: Në zgjedhje të dalë Luli, Shkëlzeni, apo kush të dojë

Opozita është larguar nga mbledhja e Këshillit Bashkiak pas akuzave në drejtim shumicës për projektin e Teatrit të ri

Opozita është larguar nga mbledhja e Këshillit Bashkiak pas akuzave në drejtim të Veliajt dhe shumicës për projektin e Teatrit të ri. Në fillim të mbledhjes, kreu i grupit të këshilltarëve të PD, Kreshnik Çollaku, akuzoi socialistët se po uzurpojnë pronën. "Do mbaheni mend si njerëzit që i shembët teatrin qytetit", tha Çollaku, ndërsa më pas u largua nga salla me grupin PD-LSI, së bashku me përfaqësuesen e FRD, Mirela Bogdani, e cila iu bashkua opozitës në Këshillin bashkiak Tiranë.

VELIAJ: VIJNË PËR LEKËT
Ndërkohë që kryetari i

Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj i është përgjigjur me tone të ashpra opozitës, madje edhe duke i sfiduar për zgjedhjet lokale. Veliaj gjatë fjalës së tij u shpreh se opozita vjen në mbledhje vetëm për të marrë lekët, pagën si këshilltarë. "Po hyjmë në një fazë destruktive para zgjedhjeve. Më thoni çfarë pune bëni që të bëj. Vini vetëm për të marrë lekët. S'bëni asnjë punë. Mirë mo ndiqeni të gjithë Lulin, por e dini të gjithë se ku do përfundojë kjo histori", tha kryebashkiaku.

SFIDA E KRYEBASHKIAKUT

Më tej Veliaj i sfidoi demokratët duke thënë se vi-

tin tjetër për zgjedhjet lokale në garë për bashkinë le të dalë kush të dojë nga opozita si kundërshtar, por nuk kanë bërë asnjë punë për Tiranën. "Të vijë kush të dojë, Dashi, Jorida, Pollo, Paloka, Luli, Shkëlzeni. Pyetja është ca do thonë mo vlla se kur e kishin 4 vjet fjetën gjumë tani do jenë superaktive, edhe ai 10 % i Tiranës do thotë shumë mirë që do dilni kundër lalit, por ca keni bërë këto 4 vjet, se fjetët gjumë edhe në opozitë, ca punë doni, ca ka një pemë që ju do mbillni? Asnjë pemë s'ka mbjellë një parti në opozitë. Në këtë seancë ndihem keq për ta. Mos u habisni po të fillojnë prape cadrat, gjërat se do jemi në prag



Detajet

AKUZA E OPOZITËS

Kreu i grupit të këshilltarëve të PD, Kreshnik Çollaku, akuzoi socialistët se po uzurpojnë pronën. "Do mbaheni mend si njerëzit që i shembët teatrin qytetit", tha Çollaku, ndërsa më pas u largua nga salla me grupin PD-LSI

PËRGJIGJJA E VELIAJT

"Po hyjmë në një fazë destruktive para zgjedhjeve. Më thoni çfarë pune bëni që të bëj. Vini vetëm për të marrë lekët. S'bëni asnjë punë. Mirë mo ndiqeni të gjithë Lulin, por e dini të gjithë se ku do përfundojë kjo histori"

zgjedhesh mos u habisni po të jemi në një situatë destruktive", deklaroi Erion Veliaj.

Pas largimit të opozitës Këshilli Bashkiak ka miratuar vendimet që kishte rendi i ditës. Bashkia e Tiranës i ka akorduar bashkisë së Athinës



50 mijë euro ndihmë për përballimin e situatës së zjarreve. Një tjetër vendim me rëndësi ishte edhe ai për miratimin e kompensimit të energjisë elektrike për shtresat në nevojë.

TEATRI I RI / IRONIA E KRYEBASHKIAKUT: LULI SI HAXHI QAMILI

Veliaj përshëndet petitionin e 54 artistëve pro teatrit



Kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj përshëndeti nismën e ndërmarrë nga artistët më të njohur të vendit të cilët përmes një peticioni drejtuar institucioneve më të rëndësishme në vend kërkojnë ndërtimin e një teatri modern. Teksa u shpreh se Tirana nuk ka më kohë për të humbur, Veliaj shprehu vendosmërinë e institucionit që drejton për të çuar përpara projektin për t'i dhënë kryeqytetit një teatër të ri. "Jam i vendosur që të ecim përpara me teatrin. Sapo më informuan që të gjithë artistët kanë bërë një petition, artistët më në zë të vendit, drejtuar autoriteteve, Presidentit të Republikës, kryeministrit, kryetarit të Kuvendit, kryetarit të Bashkisë, delegacionit Evropian, OSBE, me një apel shumë të thjeshtë, le të mos humbasim kohë! Sot deri dje u bënim ne apel artistëve, sot jemi bërë aq qesharakë, sa i bëjnë apel artistët politikës sonë: Mos humbisni më kohë, çfarë po na lodhni, tani që u bindëm, hajde ecim përpara se realisht nuk do na falë historia për këtë humbje spektakolare kohe", tha ai.

Kreu i Bashkisë deklaroi se

forma e zgjedhur për ndërtimin e teatrit të ri në Tiranë është aplikuar më parë me sukses edhe në qytete të tjera të Europës, të cilat kanë bashkëpunuar me privatën për të financuar ndërtimin e një veprë të re. Veliaj e cilësoi papjekuri qëndrimin e mbajtur nga kryetari i PD, Lulzim Basha që tenton të bllokojë ndërtimin e teatrit të ri, ndërsa e krahasoi atë me Haxhi Qamilin. "Kryetari i Bashkisë së Firences, prishi teatrin e vjetër, nga një ofertë e ngjashme nga një privat, prishi teatrin e vjetër, tek teatri i vjetër po bëhet ndërtesa e privatit, tek një vend tjetër po bëhet teatri i ri. Ne do na kishin kryqëzuar të bënim të tillë gjë. Ne themi teatër i ri 30 milionë euro pa asnjë lekë nga shteti dhe nga Bashkia, ultra modern. Del Luli që nuk nguli një gozhdë dhe tha Bjarke Ingels non grata. Si mund të jesh kaq kalama i papjekur, duhet të jesh komplet kalama. Ne themi jo, non grata se për Haxhi Qamilin ne për sa kohë që kemi të gjithë llumin me vete, çfarë na intereson ne të zhvillohet vendi, si mund të ketë një kalama drejtues opozite dhe thotë non grata arkitekti më i famshëm sot në botë", deklaroi Veliaj.

Zjarri masiv

Tirana solidarizohet me Athinën, 50 mijë € ndihma

Tirana solidarizohet me Athinën dhe i ofron ndihmë për përballimin e situatës që shkaktoi zjarri apokaliptik që përfshiu një lagje të kryeqytetit grek. Erion Veliaj i ka propozuar Këshillit Bashkiak që të miratojë dhënien



e një ndihme financiare prej 50 mijë eurosh për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga zjarri masiv që përfshiu periferinë e Athinës. Vendim ky që është miratuar me votat e mazhorancës, pasi opozita u largua nga mbledhja.

Në fjalën e tij para Këshillit Bashkiak, Veliaj teksa bëri propozimin theksoi se kjo është një ndihmë modeste, por që tregon se Tirana i gjendet sot Athinës në krah për të përballuar

këtë fatkeqësi natyrore. "Ajo që ka ndodhur gjatë ditëve të fundit në Athinë na ka shokuar të gjithëve. Është një tragjedi e përmasave të tmerrshme që s'mund të lërë askënd indiferent. Kam ndërjerë vërtet shumë dhimbje për të gjithë burrat, gratë dhe fëmijët që humbën jetën si pasojë e një zjarri aq të furishëm e masiv. Por jam ndërjerë edhe shumë krenar për solidaritetin që kanë treguar të gjithë qytetarët shqiptarë me fqinjët tanë në këto ditë të vështira. Vetëm pak javë më parë unë pata rastin të vizitoj Bashkinë e Athinës ku patëm një takim shumë të mirë me homologun tim ku diskutuam për mënyrën sesi mund të rrisim bashkëpunimin mes dy qyteteve tona. I kam shprehur kolegut tim ngushëllimet më të ndjera në emër të gjithë qytetarëve të Tiranës, por vendosëm që pavarësisht mundësive tona modeste të ofrojmë edhe një ndihmë konkrete financiare për të ndihmuar sadopak në lehtësimin e pasojave të asaj tragjedie", tha Veliaj.

MBLEDHJA E KESHILLIT BASHKIAK



Peticioni
TIRANE

Një grup artistësh, kryesuar nga të mëdhenjtë e skenës shqiptare, Robert Ndrenika, Luftar Paja, Alfred Trebicka, Leka Bungo, Albert Minga, Arben Derhemi, por edhe djali i të madhit Kadri Roshi, Kliti Roshi, regjisori Spiro Duni, aktorët Artan Imami, Sotiraq Bratko, Zamira Kita e shumë të tjerë, i janë drejtuar sot me një peticion Presidentit të Republikës, Ilir Meta dhe krerëve më të lartë të shtetit në vend, si dhe Delegacionit të Komisionit Europian në Tiranë, ku shprehin vullnetin e tyre pro ndërtimit të një Teatri të ri Kombëtar, bashkëkohor dhe modern.

Peticionit i janë bashkuar edhe aktorët e dashur për publikun, Gazmend Paja, Erion Isai, Gent Hazizi, Violeta Trebicka, Genti Kame, Ledio Lako, Roland Saro, Erblin Bajko, Olsi Bylyku, Irgen Çela, e shumë të tjerë, të cilët shprehin se teatri i ri modern do t'i shërbejë të gjithë komunitetit artistik teatrore e publikut artdashës, si dhe kërkojnë që të mos humbet më kohë, por të nisë puna për t'i dhënë Tiranës dhe Shqipërisë Teatrin Kombëtar të së ardhmes.

“Ne aktorët, regjisorët dhe përfaqësuesit e artit skenik shqiptar, dëshirojmë t’iu bëjmë me dije dhe të shprehim vullnetin tonë me anë të këtij peticioni të hapur, se jemi për ndërtimin e një Teatri të ri Kombëtar, bashkëkohor dhe modern, ku t’i shërbejë të gjithë komunitetit artistik teatrore dhe publikut artdashës.

Ritheksojmë, se jemi për ndërtimin e një Teatri të ri Kombëtar, modern dhe bashkëkohor, në truallin e tij dhe pa cenuar asnjë centimetër të kësaj prone. Le të mos humbasim me kohë, por t’i japim Tiranës dhe Shqipërisë Teatrin Kombëtar të ardhmes”, shkruhet në peticion, ku janë listuar më pas emrat dhe firmat e aktorëve, regjisorëve dhe përfaqësuesve më të njohur të artit skenik shqiptar.

Peticioni i drejtohet edhe

51 artistë kërkesë Presidentit: Thuaji “Po” ndërtimit të Teatrit të ri

Ja letër-kërkesat ku artistët shprehin vullnetin e tyre pro ndërtimit të një Teatri të ri Kombëtar, bashkëkohor dhe modern

LISTA E EMRAVE TË FIRMETAREVE TE PETICIONIT

Robert Ndrenika	Violeta Trebicka
Luftar Paja	Gazmend Paja
Alfred Trebicka	Roland Saro
Spiro Duni	Jorke Broka
Leka Bungo	Erblin Bajko
Albert Minga	Olsi Bylyku
Arben Derhemi	Edmond Lako
Sotiraq Bratko	Ilir Muhametaj
Kliti Roshi	Ledio Lako
Zamira Kita	Irgen Çela
Artan Imami	Klesta Shero
Genti Kame	Roerd Toçe
Genti Deçka	Ami Hansellia
Arjola Basha	Andon Koço
Gent Hazizi	Jonida Beqo
Gerti Ferraj	Laid Ymeri
Hervin Çuli	Danier Shkurti
Suela Konjari	Edvin Mustafa
Laxarela Deti	Valdano Bajrami
Mateus Frroku	Besart Cani
Paola Kodra	Armela Demaj
Blerta Belliu	Engjell Hoxha
Shkelqim Jaupi	Ajlçe Petrela
Guri Koço	Madi Selimi
Klaudia Hila	Fatjon Sulstarova
Nelson Mulla	Ermonela Alikaj
Erion Isai	Serkida Rrapollari

Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Delegacionit të Bashkimit Europian dhe Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE). Artistët që kanë nënshkruar janë: Robert Ndrenika, Luftar Paja, Alfred Trebicka, Spiro Duni, Leka Bungo, Albert Minga, Arben Derhemi, Sotiraq Bratko, Kliti Roshi, Zamira Kita, Artan Imami, Genti Kame, Genti Deçka, Arjola Basha, Gent Hazizi, Gerti Ferraj, Hervin Culi, Suela Konjari, Laxarela Deti, Mateus Frroku, Paola Kodra, Blerta Belliu, Shkelqim Jaupi, Guri Kocco, Klaudia Hila, Nelson Mulla, Erion Isai, Violeta Trebicka, Gazmend Paja, Roland Saro, Jorke Broka, Erblin Bajko,




Olsi Bylyku, Edmond Lako, Ilir Muhametaj, Ledio Lako, Irgen Çela, Klesta Shero, Roerd Toçe, Ami Hansellia, Andon Koço, Jonida Beqo, Laid Ymeri, Danier Shkurti, Edvin Mustafa, Valdano Bajrami, Besart Cani, Armela Demaj, Engjell Hoxha, Ajlçe Petrela, Madi Selimi, Fatjon Sulstarova, Ermonela Alikaj e Serkida Rrapollari

Artan Imani Godinën e re të TK, do ta monitorojmë, s’do të lejojmë përfitime




Në një prononcim për “Report Tv”, aktori Artan Imami ka folur mbi peticionin e artistëve drejtuar presidentit Meta për kalimin e ligjit për shembjen e Teatrit Kombëtar. Imami është shprehur se të gjitha plejadat e aktorëve kanë kërkuar një Teatër Kombëtar me të gjitha kushtet por vetëm ata patën rastin që të pyeten. Sipas tij, aktorët do të monitorojnë çdo hap të procesit në mënyrë që të mos lejohen përfitime. “Të gjitha plejadat kanë qënë të interesuara për të pasur një Teatër Kombëtar që t’i përmbushte të gjitha kushtet. Ne patëm fatin që të pyetemi. Ne duam që të jemi pjesë e kësaj vendimmarrje kështu që asnjëri nuk mund të bëjë hile. Duhet të sigurohemi jo vetëm për pamjen e jashtme. I gjithë ky debat e pati një fund të shumë të mirë dhe bëri që produkti final të jetë serioz. Ne ia arritëm me protestën tonë. Mirë do ishte që ne ta shohim që në fillim planin e detajuar për Teatrin por e dimë që diçka e tillë në një fazë nuk është i mundur për shkak të kostove financiare. Më në fund ne do të jemi në skenë dhe ju në sallë, ta ndiejmë veten ne-artistë dhe ju-publik”, u shpreh aktori i njohur Artan Imani.



Shkuan për të bërë gjyq, dhjetë persona përgjaken në gjykatë

Konflikti për një gurore në Vlorë solli dhe përplasjen mes dy grupeve në gjykatë

Një proces gjyqësor në qytetin bregdetar ka sjellë një konflikt mes dy biznesmenëve dhe përplasje fizike jashtë ambienteve të gjykatës, ndërsa tre persona janë lënduar dhe tre të tjerë janë shoqëruar nga policia për t'u marrë në pyetje në lidhje me konfliktin, V.D. N.D. K.S. Shერი ka nisur për rrugën që të dërgon në një gurore në Lepenicë në bashkinë e Selenicës. Gurorja fillimisht ka qenë në bashkëpronësi të biznesmenit Ylli Salla nga Elbasani dhe Vendim Durmishajt, banor i zonës në Lepenicë. Por pas konfliktit mes tyre, Durmishaj pretendon se Salla e mori me vendime të dyshimta në gjykata guroren, ndërkohë që i bllokoi rrugën. Ai thotë se Salla nuk ka paguar shpenzimet për ndërtimin e rrugës prandaj e ka bllokuar. Çështja përfundoi në gjykatë dhe sot Apeli i dha të drejtë biznesmenit duke e lejuar që të kalojë në rrugën që të dërgon në gurore, të cilën Durmishaj pretendon se ndërtoi ai dhe jo biznesmeni Salla nga Elbasani dhe se nuk ka derdhur asnjë kontribut. Por Salla është shprehur në gjyq se rruga është e të gjithëve dhe mund të kalojë kushdo, ndërsa trupi gjyqësor i dha të drejtë. Debatit me fyerje dhe sharje nisur në ambientet e brendshme të gjykatës pas vendimit përfundoi me përleshje jashtë. Vendim Durmishaj që shoqërohej nga familjarët është përplasur fizikisht me biznesmenin Salla dhe personat që e shoqëronin.



Arlinda Durmishaj



Ylli Salla

SHERRI ME 10 PERSONA

Në sherr janë përfshirë 10 persona, ndërsa tre janë lënduar, biznesmeni Salla dhe Vendim Durmishaj

me djalin. Ata kanë marrë disa plagë në kokë dhe pjesë të tjera të trupit nga përplasia, por ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Policia ka

shoqëruar në komisariat Vendim Durmishaj, djalin e tij dhe Z.H. rreth 53 vjeç, banues në Peqin, që shoqëronte Sallën, për të sqaruar ngjarjen. Biznesmeni Ylli Salla në një prononcim për "Report Tv" pas sherrit akuzon se banorët i kanë zënë pritë para hyrjes së gjykatës duke e qëlluar me sende të forta. Ai thotë se për shkak të këtij konflikti firma ka pezulluar aktivitetin prej dy vitesh. "Na goditën me thika, me sëpatë, personat që ishin në gjyq, kunetërit e Bernard Caushajt me bandën e tij nga Selenica, unë jam përfaqësues i një biznesi gurore, jam në proces gjyqësor, kemi dy vite që kemi pezulluar punën jemi në proces. Këta na kanë bllokuar rrugën nuk na lënë të kalojmë. Ngjarja ndodhi sa zbritëm

nga makina, jashtë sallës, na kishin zënë pritë, na goditën me doreza, hunj"-thotë Ylli Salla.

"TË PAGUAJNË MË PAS TË KALOJNË"

Ndërkohë që gruaja e vendim Durmishajt, Arlinda shprehet se ishte biznesmeni Salla që provokoi situatën pas vendimit, që solli edhe përplasjen fizike. Ajo akuzon gjykatën për vendimin në favor të Sallës, ndërsa shton se biznesmeni është person me influencë prandaj ka fituar gjyqin. "Kam dy vite në gjykata dhe polici. Burri hapi një gurore dhe afroi një ortak nga Elbasani, bëri dokumentet, por më pas hoqi emrin e burrit dhe la vetëm emrin e tij. Bëmë një rrugë për të shkuar te gurorja, kanë kontribuar burri im me një firmë tjetër, Salla kërkon të kalojë në atë rrugë, por ne duam që të hedhë njëherë lekët dhe pastaj të kalojë. Gjykata i dha të drejtë, në momentin që u fut në gjykata dikush provokoi, pasi konflikti, Salla lajmëroi policinë që arrestoi disa. Përse do të vazhdonte gjyqi kur ata po vriteshin, gjykata po u jep drejtësi atyre që paguajnë, merr rryshfet. Po më mbesin fëmijët rrugëve, burri kaloi në depresion, u vetëhelmua, Zoti e ktheu në jetë"-thotë Arlinda Durmishaj.

TRE TË PLAGOSUR

Në sherr janë përfshirë 10 persona, ndërsa tre janë lënduar, biznesmeni Salla dhe Vendim Durmishaj me djalin. Ata kanë marrë disa plagë në kokë dhe pjesë të tjera të trupit nga përplasia, por ndodhen jashtë rrezikut për jetën.

NGJARJA NË VLORË

Bie nga lartësia gjatë kontrollit për kanabis, polici kurohet në Tiranë

Gjatë një operacioni të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, për kontrollin e parcelave të kanabisit në jug të Shqipërisë, një punonjës i SHÇBA-së është rrëzuar nga disa metra lartësi duke lënduar shpatullën.

Ngjarja ka ndodhur në malet e Vranishtit ku policët po zhvillonin një operacion për të kontrolluar nëse ka patur mbjellje të parcelave me kanabis. Burimet bëjnë me dije se operacioni i shpëtimit ka zgjatuar rreth 30 minuta, ndërkohë që mësohet se gjendja e policit në spitalin e Traumës është jashtë rrezikut për jetën. Efektivi është transportuar me helikopter nga Vlora drejt Tiranës, ndërkohë Report Tv ka



siguruar pamjet ekskluzive të shpëtimit të policit. Siç shihet edhe nga pamjet helikopteri e ka patur të pamundur të shkojë në vendin e plagosjes, ndërkohë që transportin e tij deri në vendin ku ndodhej helikopteri e kanë bërë mjekët dhe kolegët e tij. "Në kuadër dhe në zbatim të planit të

masave të marra për kontrollin e territorit kundër kultivimit të bimëve narkotike gjatë paradites së sotme punonjës policie të DVP Vlorë së bashku me specialistë të SHÇBA-së në DVP Vlorë kanë ushtruar kontrolle në një zonë të thyer malore pranë fshatit Vranisht. Gjatë patrullimit në këtë zonë specialisti i SHÇBA-së, B.H., 33 vjeç, nuk është ndjerë mirë nga ana shëndetësore dhe ka rrëshqitur në një zonë të thyer. Për pasojë ka marrë dëmtime në krahë. Për shkak të terrenit ai është transportuar me helikopter në drejtim të Tiranës për të marrë ndihmë më të specializuar mjekësore dhe aktualisht është jashtë rrezikut për jetën"-thuhet në njoftimin e policisë së Shtetit.

NGJARJA NË DEVOLL

Kontrabandë me pijet energjike, arrestohen 3 doganierë në Kapshticë

— Tre doganierë janë arrestuar nga policia për shpërdorim detyre dhe kontrabandë me mallrat që paguhet akcizë. Ndërkohë që është sekuestruar një sasi pijesh të dyshuara si kontrabandë, për të cilat tre doganierët dyshohet se kanë lejuar kalimin e tyre, pa ushtruar kontrollin përkatës. Doganierët e arrestuar janë: Floben Guxho 46 vjeç, banues në Tiranë, Klodian Nastimi 34 vjeç, banues në Devoll dhe Rernato Molla 33 vjeç, banues në Pogradec. Ndërsa në pranga janë vendosur edhe Kristi Meslani 23 vjeç, Rezart Shega 29 vjeç dhe Mario Berberi 26 vjeç, të gjithë banues në Devoll, që kaluan pijet energjike. Arrestimi i tyre u bë pasi, në aksin rrugor Bilisht-Korçë, në afërsi të fshatit Dishnicë, nga shërbimet e Policisë, janë kapur në flagrancë Kristi Meslani dhe Rezart Shega të cilët drejtonin mjetet me targa AA 170 UF dhe AA 226 GH, duke transportuar një sasi të konsiderueshme me pije energjike dhe pije të tjera, të dyshuara si kontrabandë të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale. Ndërsa Mario Berberi, dyshohet të jetë porositi i këtij malli. Nga verifikimet e kryera, rezultoi se këto mjete kanë kaluar nga Pika e Kalimit Kufitar Kapshticë, ku dyshohet se nuk i janë nënshtruar procesit përkatës të kontrollit doganor. Materialet në ngarkim të tyre i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

NGJARJA NË TIRANË

"Pse s'më hap rrugën" Sherr mes të rinjve në Tiranë, të shtëna te zona e Tregut Elektrik

— Një konflikt mes dy personave dhe dy të shtëna me një pistoletë zhurmuese kanë sjellë panik te qytetarët. Ngjarja ka ndodhur paraditen e sotme te zona e njohur si Tregu Elektrik. Sipas njoftimit të policisë së Tiranës, rreth orës 09:30 minuta në rrugën "Vath Koreshi" personi me inicialet K.K., për shkak të një konflikti me një tjetër person ka gjuajtur dy herë në ajër me një pistoletë zhurmuese, dhe më pas është larguar nga vendngjarja. Banorët kanë lajmëruar menjëherë policinë, e cila ka mbërritur në vendngjarje, ndërsa ka gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale dy gëzhoja të qitura nga pistoletë zhurmuese. Shkak i të shtënave te Tregu Elektrik ka qenë shერი për rrugën. Personi që është në kërkim, K.K. mësohet se i ka kërkuar personit me të cilit u konfliktua që ti hapte rrugën, ky i fundit i ka thënë se ai ka të drejtë kalimi. Të rinjtë kanë afruar makinat me njëri tjetrin më pas K.K. ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar. Policia po punon për arrestimin e autorit dhe zbardhjen e plotë të ngjarjes.

Lirohet nga qelia Dash Xhika, gjykata: Ish-drejtori i sëmurrë

Dashamir Xhika i arrestuar për 2 çështje penale, në Gjinar-Elbasan dhe Tiranë-Elbasan

Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda ka liruar nga burgu ish-drejtorin e ARRSH, Dashamir Xhika. Trupi gjykes pranoi kërkesën e avokatit duke vendosur që Xhika të hetohet në masën e sigurisë “arrest shtëpie”. Ish-kreu i Autoritetit Shqiptar të Rrugëve u prangos me akuzën e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës. Xhika, së bashku me Andi Tomën, ish-Drejtorin e Rrugëve, që u lirua në maj të këtij viti dhe disa zyrtarë të tjerë u arrestuan në datë 2 shkurt për abuzime me fondet e rrugës Elbasan-Gjinar në vlerën e 5 mln eurove. Vendimi për ndryshimin e masës së sigurisë është marrë në datë 23 korrik në fshehtësi. Mësohet se Xhika nuk ndodhej në burgun e Fushë Krujës, pasi ishte liruar dhe hetimet do të vijojnë në “arrest shtëpie”. Mësohet se në vendim theksohet se “Xhika nuk ndodhet në gjendje të mirë shëndetësore, nuk ka rrezik për tu larguar jashtë vendit dhe hetimet kanë përfunduar dhe nuk mund të ndërhyjë në hetime. Është person i arsimuar dhe nuk ka rrezik për të ikur”.

XHIKA I ARRESTUAR PËR 2 ÇËSHTJE PENALE

Por Xhika nuk është i akuzuar vetëm për dosjen e Gjinarit, por edhe për aksin Tiranë-Elbasan, i nisur shumë vite më parë dhe ende i papërfunduar. Ndërtimi i rrugës Tiranë-Elbasan ishte parashikuar të kushtonte 407 milionë dollarë sipas kontratës së qeverisë shqiptare me bankën islamike në vitin 2011. Por, në auditin e Ministrisë së Infrastrukturës në materialin kallëzues theksohet se ka një dëm prej 54 milionë dollarë. Për hetimet për rrugën Tiranë-Elbasan janë marrë në pyetje në prokurori edhe ish-ministrat Haxhinasto dhe Dervishaj.

VEPRIMET ABUZIVE TË DASHAMIR XHIKËS

Dashamir Xhika, gjatë ushtrimit të detyrës së tij si Drejtor i Përgjithshëm i ARRSH-së në periudhën Tetor 2013 – Shtator 2017. Sipas dosjes së akuzës së Elbasanit Xhika ka përgjegjësi ligjore për veprime dhe mosveprime të kundërligjshme, që lidhen me ushtrimin e detyrës së tij



si Drejtor i Përgjithshëm i ARRSH-së dhe përfaqësues i Autoritetit kontraktor-Investitorit, gjatë realizimit të objektit “Sistemim Asfaltim rruga e Gjinarit”. Prokuroria thotë se me veprimet dhe mosveprime të kundërligjshme Xhika ka miratuar dhe lejuar që fondet publike të dhëna nga buxheti i shtetit të shumën prej 5 miliardë lekë të vjetra të administroheshin dhe të përdorreshin

në mënyrë të kundërligjshme nga shoqëria “Vëllezërit Hysa” sh.p.k, ndërkohë që sipas procedurës së prokurimit publik fituese kryesore për realizimin e punimeve në objektin “Sistemim Asfaltim rruga e Gjinarit” ishte shpallur shoqëria “Arifaj” sh.p.k. Në akt-akuzën e saj prokuroria e Elbasanit sqaron se Xhika nuk ka ndërmarrë asnjë veprim apo masë ligjore për ndërprerjen e

Shëndeti

Mësohet se në vendim theksohet se “Xhika nuk ndodhet në gjendje të mirë shëndetësore, nuk ka rrezik për tu larguar jashtë vendit dhe hetimet kanë përfunduar dhe nuk mund të ndërhyjë në hetime.



kësaj situatë të kundërligjshme, por në mënyrë kriminale ka nënshkruar 1 kontrata shtesë “Për shtyrjen e afatit për punimet e ndërtimit të objektit “Sistemim Asfaltim rruga e Gjinarit”, duke miratuar dhe “legjitimuar” zvarritjen e theksuar të kryerjes së punimeve në objekt, në vijim të zgjatjeve të vendosura edhe më parë nga Drejtori i mëparshëm Andi Toma. Gjithashtu Xhika nuk ka ndërmarrë asnjë masë apo veprim ligjor për të verifikuar dhe kontrolluar cilësinë e kryerjes së punimeve në objekt Këto veprime dhe mosveprime të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së Dashamir Xhika janë në kundërshtim me 6 ligje të përmendura edhe në akt-akuzën e ish-drejtorit Andi Toma. Këto veprime dhe mosveprime të kundërligjshme të Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së Dashamir Xhika kanë sjellë këto pasojë, të cilat dëmtojnë interesin e shtetit, por edhe të komunitetit të zonës ku shtrihet rruga e Gjinarit.



Ish-ministrat

Por, në auditin e Ministrisë së Infrastrukturës në materialin kallëzues theksohet se ka një dëm prej 54 milionë dollarë. Për hetimet për rrugën Tiranë-Elbasan janë marrë në pyetje në prokurori edhe ish-ministrat Haxhinasto dhe Dervishaj.

Nuk ka përfunduar faza e marrjes përfundimtare në dorëzim të objektit “Sistemim Asfaltim rruga e Gjinarit”, ndonëse të gjitha fondet janë harxhuar dhe kanë kaluar rreth 9 vjet nga koha e fillimit të punimeve në këtë objekt. Objekti “Sistemim Asfaltim rruga e Gjinarit” paraqet mangësi të theksuara lidhur me kushtet teknike dhe të standarteve rrugore, si: mungesa e shtresës së asfaltbetonit në të gjithë gjatësinë e rrugës; mungesa e sinjalistikës vertikale dhe horizontale, mungesa e mbrojtëseve rrugore, bankinave, ndriçimit, etj. Zvarritja e theksuar në kryerjen e punimeve, të miratuar edhe Kontratë Shtesë të nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH-së Dashamir Xhika, kanë sjellë si pasojë që ujrat nëntokësore dhe rreshjet të mbingopin me uje tokën dhe te demtohet struktura e saj, duke sjellë rrëshqitjet, problem i cili nuk është zgjidhur asnjëherë ndonëse të gjitha fondet publike janë haxhuar.

Ngjarja në Korçë

Sherr me sende të forta kapen në flagrancë 3 shtetas

Policia e Korçës ka arrestuar në flagrancë tre shtetas pas një sherri me sende të forta. Tre të arrestuarit janë konfliktuar me një të ri në Mborje të Korçës. I riu i pagosur është dërguar në spital për ndihmë mjekësore. Specialistët e Seksionit për Krime në Komisaratin e Policisë Korçë, bënë kapjen dhe arrestimin në flagrancë të D.H, 17 vjeç, O.R, 16 vjeç dhe Xh.B, 17 vjeç, të tre banues në fshatin Mborje-Korçë. Arrestimi i tyre u bë pasi, më datë 25 korrik 2018, në fshatin Mborje, këta shtetas në bashkëpunim mes tyre, dyshohet se pas një konflikti për motive të



dobëta, kanë goditur me sende të forta shtetasin S.K, 21 vjeç, banues në Mborje, i cili është dërguar në spital për ndihmë mjekësore. Materialet në ngarkim të tyre i kaluan Prokurorisë së Korçës.



NGJARJA NË SARANDË

Sekuestrohen 60 kg kanabis, arrestohet drejtuesi i mjetit

Ditën e djeshme është finalizuar me sukses operacioni “Return”, ku është bërë arrestimi në flagrancë i Arben Nguli nga Librazhdi, banues në Sarandë. Arrestimi i tij u bë pasi në vendin e quajtur “Qafa e Hanit” në rrugën Sarandë-Qafë-Bot, Arben Nguli po udhëtonte me mjetin tip KIA, dhe nga kontrolli që i është bërë në pjesën e dyshemësë është konstatuar një vend i improvizuar ku i janë gjetur sasi lënde narkotike kanabis-sativa e ndarë në 58 pako me peshë 60 kilogramë. Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së shkallës së Parë Sarandë.

NGJARJA

Kapen 8 refugjatë në Kapshticë, 5 sirianë dhe 3 palestinezë

Ditën e djeshme janë kapur 8 refugjatë në pikën kufitare të Kapshticës. Shtetasit ishin 5 sirianë dhe 3 palestinezë. Ata janë shoqëruar në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit për marrjen e deklaratave. Para pak disa çastesh janë nisur drejt qendrës së azilkerkuesve në Babrru.



NGA VALERIA DEDAJ
TIRANE

Instituti i Ndërtimit bën vlerësimin teknik të Bibliotekës Kombëtare një muaj pas përmbytjeve, edhe zjarrit që ra një vit më parë. Përmbytjet para një muaj, sipas raportit, kanë ndodhur për shkak të vjetërsisë së objektit.

Ndërsa, impianti i mbrojtjes nga zjarri ka nevojë për ndërhyrje të thella rikonstruktive. Ekspertët theksojnë se mungon hidrolizimi i bazamentit të themeleve, si dhe i faqeve anësore të bodrumit.

Dicka e tillë nuk është marrë parasysh që në projektim. Sipas tyre, në periudhën kur është krijuar objekti nuk ka pasur një studim të mirëfilltë hidrolologjik për zonën. Prandaj sot Biblioteka Kombëtare gjendet në situatën ku është

PËRMBYTJA

Vjetërsia e objektit, dëmtimet që ka pasur objekti në dyshemenë e tij dhe mosmarrja e masave mbrojtëse, që në projektim janë sipas Institutit të Ndërtimit arsyt kryesore, që ka ndodhur evadimi i ujërave në ambientet e bodrumeve të Bibliotekës.

Në ekspertizë "faji" kryesor i depërtimit të shiut në Bibliotekë është i mungesës së studimeve hidrolologjike dhe i masave mbrojtëse për hidrolizim të objektit për këtë zonë që gjatë projektimit të ndërtesës. Fenomeni i daljes së ujit në dyshemenë e objektit, sipas specialistëve të shtetit ka ardhur, si rezultat i rritjes së nivelit pjezometrik të zonës.

Sipas ekspertëve Biblioteka në themelet e saj, në shtresat e dyshemesë ka pësuar dëmtime dhe nuk e ka mbrojtur praninë e ujërave nëntokësore.

Viti 2017-2018 ka patur reshje të mëdha dhe sezoni i tyre ka filluar shumë shpejt. Sot aktualisht gjendimi në kuotën maksimale të ujërave nëntokësore dhe si rezultat i reshjeve të mëdha në sasi dhe në një kohë të shkurtër (në ditët që ndodhi përmbytja), është rritur prurja dhe niveli pjezometrik i zonës, ku ndodhet dhe tabani i themelit të Bibliotekës.

KISHTE BLOKIM KANALIZIMESH?

Ekspertët përjashtojnë futjen e ujit në BKSH për shkak të kanalizimeve apo ndonjë fenomeni tjetër. Kjo, sipas tyre provohet nga mungesa e prezencës së ujit në interkarpet në kohën kur në bodrume kishte prani të ujit.

ÇFARË DUHET BËRË?


Ekspertët theksojnë se objekti nuk plotëson standardet dhe ka një amortizim të tejshkallshëm, ndaj rekomandojnë të merren masa të menjëhershme si:

1. Largimi i materialeve nga soletat për të bërë uljen e ngarkesës dhe lehtësimin e tyre.
2. Kryerjen e provave laboratorike për strukturat si karrotazhe, sonografi, tomografi. Kryerjen e spektrave të momenteve për strukturat.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për hidrolizimet e nevojshme, në ambientet e bodrumeve të objektit, si dhe shtrimet e shtresave të dyshemesë, pasi janë jashtë çdo



Zbulohet shkaku i zjarrit dhe ujit në Bibliotekën Kombëtare

Instituti i Ndërtimit bën vlerësimin teknik pas përmbytjeve edhe zjarrit që ra një vit më parë: Kanë ndodhur për shkak të vjetërsisë së objektit



Faksimile të vlerësimit teknik të Bibliotekës Kombëtare nga Instituti i Ndërtimit



kushti teknik.

4. Të bëhet heqja e suvatimeve të vjetra, pasi janë tejet të degraduara dhe të zëvendësohen me të reja. Duhet bërë ndërhyrje totale, mbi bazën e një projekti të studiuar, për rritjen e performancës së strukturave si dhe rifiniturës së vet ambienteve.

MBROJTJA KUNDËR ZJARREVE JOEFIKASE

Sipas ekspertizës rezultojnë jashtë normave teknike impianti i mbrojtjes kundra të hidrantëve me ujë si dhe baseni ujqor i shatërvanit që shërben si rezervë ujore (i përkasin instalimeve origjinale 1963-1964).

RREZIKU PËR ZJARR I 2017-ËS ISHTE PARALAJMËRUAR

Në vlerësimin teknik bërë BKSH pohohet se, konstatimet janë paralajmëruar që në korrik të vitit 2016.

Me rënien e zjarrit në 15.03.2017 dhe nga ekspertiza e repartit të mbrojtjes kundër të janë konstatuar të njëjtat probleme të sistemit të mbrojtjes.

ÇFARË DUHET BËRË?

Impianti i mbrojtjes nga zjarri ka nevojë për ndërhyrje të thella rikonstruktive si në pikëpamje të mbrojtjes pasive ashtu edhe të mbrojtjes aktive.

IMPIANTI I SHKARKIMIT DHE UJËRAVE TË ZEZA

Impianti i ujërave të zeza dhe shiut janë dëmtuar nga ndërhyrje joprofesionale.

Impianti i shkarkimit të ujërave të zeza ka pësuar degradime edhe për shkak të teknikave të vjetra edhe të amortizuara. Ky impiant ka pasur riparime edhe ndërhyrje të pjesshme, duke rezultuar jashtë normave teknike. Ndërhyrjet joprofesionale kanë shkaktuar mosfunksionimin e tij si dhe krijimin e vatrave të lagështirës dhe mykut, duke dëmtuar kushtet e

ruajtjes së librave. RIKONSTRUKSIONI I 2012-ËS, NUK ËSHTË NË PËRPUTHJE ME NORMAT

Gjatë rikonstruksionit të fundit të bërë në vitin 2012 është vendosur një sistem automatik i mbrojtjes me pluhur, i cili nuk është në përputhje me normat pasi pluhuri si mjet shuarës në ambientet e Bibliotekës është i ndaluar.

Pavarësisht kësaj sistemi i shuarjes me pluhur nuk është efikas, sepse vendosja e bombolave është jo në korrespondencë me hapësirat ndërmjet rafteve dhe lë pjesën më të madhe të sipërfaqes të pambrojtur. Ky sistem i mbrojtjes nga zjarri nuk funksionon as në raftet e sipërme, sepse lartësia e vendosjes së librave është më e madhe se lartësia që mund të mbulojnë bombolat e pluhurit.

MUNGESA E HAPËSIRAVE:

Sipas rezultateve të ekspertëve të shtetit, të cilët janë bazuar në informacionet e marra nga administrata e Bibliotekës Kombëtare, hapësirat në funksion të Bibliotekës kanë më shumë, se 20 vjet që nuk i plotësojnë nevojat e këtij institucioni.

Raftet "imagjinare" të krijuara për shkak të mungesës së hapësirave, përgjatë korridoreve dhe shkallëve të kateve bodrum jo vetëm pengojnë shërbimin ndaj përdoruesve, por edhe pengojnë daljen e personelit në raste emergjente (tërmet, zjarr, përmbytje).

Sipërfaqja aktuale e hapësirave depozituese të njësive bibliotekare është rreth 6 herë e gjysmë më e vogël sesa duhet referuar Standardeve të IFLA-s. (Instituti dhe Federata Ndërkombëtare e Librit). (Duhet të jetë jo më pak se 10000m2 ndërkohë që është 1560m2)

STRUKTURA


Sipas ekspertizës muret e objektit, sidomos në katet e bodrumit janë të degraduara për shkak të lagështirës dhe në disa sipërfaqe ato shfaqen edhe të plasurata.

Përsa i përket shtresave të dyshemesë, sipërfaqet e shtruara me parket rezultojnë të vjetra dhe jashtë standardeve për veshjen e një Biblioteke Kombëtare. Ndërsa sipërfaqet e shtruara me pllakë porcelani, të cilat gjenden kryesisht në katet e bodrumit paraqiten mjaft të dëmtuara për shkak të vjetërsisë dhe prishjes së shtresave të poshtme të tyre.

Rezultoni të kenë gjithashtu dëmtime në tavanet e kateve nëntokë, si pasojë e vjetërsisë së objektit dhe mungesës së mirëmbajtjes.

Dyert e jashtme janë të amortizuara për shkak të agjentëve atmosferikë dhe nuk përmbushin kushtet minimale të sigurisë, ndërsa dyert e brendshme dhe dritaret janë tërësisht jashtë standardit dhe të papërshtatshme teknikisht për një Bibliotekë Kombëtare. Sidomos në katet e bodrumeve dritaret, dhe sistemi i mbylljes rezultojnë të amortizuara.

RRAHJA



NGA EDISON YPI

vijon nga faqja 1

Për të tjerë që "rihnin poshtë", domethënë ishin nisur drejt greminës, nuk thuhej asgjë. Për rrahjen dhe gjithçka tjetër që ata meritonin, kujdesej syshkaba Sigurimi dhe burrnesha policia.

Rrahja ishte omniprezente. Rrahja ishte fenomen që nuk i shpëtonte dot askush. Me dajak, me grushta, me shkelma, me çizme, ose me fjalë falë newspeak-ut të George Orwellit, rrahës ose të rrahur ishin të gjithë shqiptarët.

Gjithçka që lëvizte në mënyrë ciklike apo kaotike quhej "rrahje".

Rrahja ishte edhe atje ku s'ta merrte mendja. Zhurmat problem-

atike brenda gjithçkaje që rrotullohej, çvendosej, brenda motorrave ose çdolloj makinerie, quheshin të gjitha "rrahje".

Kur doje ta përgëzoje dikend që kishte bërë ndonjë gjë të mirë, nuk ishte i detyruar të zbatoje asnjë normë mirsjelljeje, për shembull t'i thoje ndonjë fjalë inkurajuese, t'i jepje dorën, apo ta përqafoje, mjaftonte t'i "rihje" shpatullat. Nëse ja kishte me hile ose jo, pra nëse rrahja e shpatullave do mbetej me aq apo do vazhdonte me rrahje të tjera, varej nga aftësia nuhatëse e viktimit.

Këmba, shkelmi, dora, grushti i rrugaçit, këpuca e oficerit, çizmja e ushtarit, shkopi i policit, por edhe zemra, puls, syri, plaga, çekiçi, varreja, akrepi i sekondave, të gjitha vetëm "rihnin".

Për plogësinë që shkakton ndërrimi i stinëve i ankoreshin njëri-tjetrit duke i thënë; Ndjem si i rrahur.

Gjithkënd që takonin në mëngjez sapo dilnin nga shtëpia i thoshin; Aq i lodhur jam sa më duket sikur më kanë "rrahur" gjithë natën dhe mi kanë thyer të gjitha kockat.

Duke hyrë në një moskuptim torturues faktiko-linguistik, pa asnjë mundësi për të kuptuar cilat ishin mjetet dhe arsye, nuk thoshin filani kalon vazhdimisht në X rrugë, por; Filani "e rreh" shpesh atë rrugë.

Në futboll, për skuadrën që kishte pësuar më tepër gola, nuk thoshin "u mund" por thoshin dhe thonë



"u rrah".

Lebërit mburraveçë "e rrihnin" aq tepër gjoksin sa gjoksi u ishte bërë gropë.

Gruaja, thoshin, është për dy gjëra, për të bërë kalamaj dhe për ta rrahur.

Di ta rrahi mirë këtë temë, thoshin për ndonjë llafazan që fliste pafund nëpër mbledhje për rrethimin e egër imperialisto-revizionist, ose të tjera gomarllëqe.

Të doje ta zbrazje ndonjë thes nuk

mjaftonte ta tundje ose ta godisje me ndonjë shkop. Duhej me atë shkop ta "rihje".

Rrahja e kudondodhur kishte hyrë edhe nëpër proverba; "Më mirë të hash dy herë se të rrihesh dy herë".

Era dhe dallgët kurrë nuk e preknin ose lëpinin bregun e detit dhe shkëmbinjtë; gjithmonë vetëm i rrihnin.

Nuk rrihej vetëm njeriu. Rrihej edhe mishi për biftek, qeni, macja,

kafsha shtëpiake, madje edhe uji në havan.

Më tepër se të gjithë rrihnin policët nëpër rajone policie dhe gardianët nëpër burgje. Por ata dhe rrahjet e tyre askush nuk guxonte t'i zinte në gojë.

Për tu familiarizuar me rrahjen e kudondodhur, në atë mënyrë që sado e egër të ishte të mos qe fatale, e vetmja rrahje që pranohej dhe për të cilën përkujdeseshin të vazhdonte ishte rrahja e zemrës.

KINEMA MILLENNIUM

HOTEL TRANSYLVANIA 3

NGA DATA 12 KORRIK

INFO & REZERVIME:

04 22 53 654 / 04 22 53 655 / 06 978 56678

Kinema Millennium Tirana
 www.kinemamillennium.com





Laçi mundet 0-3 në Norvegji nga Molde, kualifikimi një ëndërr

Nordikët rezultuan shumë të fortë për kurbinasit, kualifikimi tani gati i pamundur. Elis Bakaj shënon për bjellorusët

Laçi merr një goditje të fortë në ndeshjen e parë të turit të dytë kualifikues të Europa League. Molde ka fituar me rezultatin e thellë 3-0 ndaj kurbinasve sfidën e parë që është zhvilluar në Norvegji. Skuadra norvegjeze e drejtuar nga ish sulmuesi i Manchester United, Solskjaer, kishte nivel shumë të lartë se ajo shqiptare dhe dominoi ndeshjen që në fillim të saj, duke shënuar në minutën e 5-të me 11-metërsh me Haland, kur Sefgjini shkaktoi një faull duke u ndëshkuar edhe me karton të verdhë. Laçi nuk arrinte dot të ndalte vrullin e sulmeve të ekipit vendas dhe jo vetëm që nuk reagoi dot, por edhe pësoi sërish. Në 24' Molde shënoi edhe golin e dytë me Hestad. Laçi u përpoq që të reagoonte me disa raste sporadike por pa sukses. Në minutat 32 dhe 34 Hoxhallari dhe Lushkja nuk shënjestruan siç duhet portën e vendasve. Në pjesën e dytë Molde e menaxhoi mirë lojën duke arritur të shënojë edhe golin e tretë në 79' me nigerianin James. Tashmë skuadrës kurbinase do t'i nevojitet një mrekulli për të përmbysur rezultatin e ndeshjes së parë në ndeshjen e kthimit në Shqipëri.



BAKAJ SHËNON SËRISH

Për të 4-ën ndeshje radhazi Elis Bakaj gjen rrugën e rrjetës për skuadrën e tij të re në Bjellorusi. Sulmuesi shqiptar ka gjetur shënuar sërish me skuadrën e tij Shakhtyor Soligorsk dhe e ka bërë përsëri në Europa League. Pas 2 golave të realizuar ndaj uellsianëve të Connahs Q dhe një goli ndaj Dynamo Brest në kampionatin bjellorus, Elis Bakaj ka shënuar edhe përballë një kundërshtari të një niveli shumë të lartë siç janë polakët e Lech Poznan. Megjithatë goli i avantazhit provizor i realizuar nga Bakaj në minutën e 53-të, nuk i mjaftoi skuadrës bjelloruse të Shakhtyor Soligorsk. Në fund të ndeshjes skuadra bjelloruese pësoi gold he takimi u mbyll 1-1.

PORTIERI

Etrit Berisha pëson dy gola në Bosnje, barazon Atalanta





Atalanta e Etrit Berishës ka qenë viktimë e një nga surprizat e mëdha të ndeshjeve të para të turit të dytë të Ligës së Europës. Skuadra italiane ka barazuar papritur në shtëpi 2-2 nga skuadra e Bosnje-Hercegovinës, Sarajevo, ku e mbylli pjesën e parë në avantazh 2-0. Tani Atalanta ka vënë seriozisht në rrezik eliminimin nga vazhdimi i Europa League. Etrit Berisha ishte si zakonisht titullar në radhët e skuadrës së tij, pavarësisht zërave të kohëve të fundit se klubi tashmë preferon Golinin në vendin e tij. Në pjesën e parë, ai nuk kishte shumë punë, pasi Atalanta dominoi dhe gjeti rrjetën me Toloj e Pesina. Por në pjesën e dytë, papritur Sarajevo u ngjall dhe bëri surprizën në vetëm 5 minuta. Hanxhiç në minutën e 67 dërgoi topin në rrjetë me një gjuajtje të befasishme. Ndërsa më pas, Susic barazoi shifrat duke përfituar nga një mosmarrëveshje mes mbrojtësve të Atalantës dhe Berishës.

ITALI

Zbardhet kalendari i Serie A, Strakosha-Hysaj përballë që në start

Në zyrat Sky Italia liga italiane e futbollit ka zbuluar kalendarin e sezonit 2018-2019 të Serie A, i cili do të nisë me shkëndija që në fillim. Aventura e Cristiano Ronaldos dhe rruga e Juventusit drejt titullit të 8-të radhazi do të fillojnë me transfertën e Veronas ndaj Chievos. Lazio-Napoli do të jetë dueli i madh i javës së parë me Strakoshën që do të sfidojë Hysajn, ndërkohë që Interi do të ketë përballë macen e saj të zezë në këto vitet e fundit, pikërisht, Sassuolon. Torino-Roma është një tjetër sfidë interesante e javës së parë ndërsa Milani ka një takim të lehtë në letër pasi pret në shtëpi Genoan. Java e dytë rezervon dy superndeshje, Juventus-Lazio dhe Napoli-Milan ndërkohë që kalendari vazhdon në malore për kuqezinjtë që në javën e tretë do të sfidojnë Romën. Juventus-Napoli do të ndezë javën e 7-të, derbi i Madoninës. Inter-Milan do të luhet në javën e 9-të, teksa java e 10-të do të ketë dy ndeshje big Lazio-Inter dhe Roma-Napoli. Në raundin e 12-të do të vihet në skenë Milan-Juventus, ndërsa java e 13-të do të kulmojë me Lazio-Milan. Për Interin dy sfida zjarri, pasi në javën e 14-të do të sfidojë Romën në Olimpico dhe në të 15-ën një javë më pas sërish në transfertë do të luajë derbin e Italisë ndaj Juventusit. Sezioni i ri i Serie A do të nisë më 18 gusht dhe këtë vit parashikohet të jetë më



spektakolar se kurrë. Ashtu si një sezon më parë edhe këtë vit futbollit në Itali nuk do mungojë as për festa teksa gjatë Boxinx Day një ditë pas Krishtlindjes do të luhet java e 18-të që kulmon me supersfidën Inter-Napoli. Juventusit kampion në fuqi do

ta mbyllë sezonin ndaj Sampdorias në transfertë. Është zbuluar edhe topi i ri i cili do të përdoret në të gjitha ndeshjet e sezonit 2018-2019 të Seria A përfshirë edhe Kupën e Italisë e Superkupën, ai quhet Nike Merlin./supersport

TRAJNERI



Besnik Hasi merr drejtimin e një skuadre në Arabinë Saudite

Pas gati një viti pushim që prej shkarkimit nga stoli grekëve të Olympiacos, Besnik Hasi ka gjetur një klub të ri për të vijuar karrierën e tij si trajner. Në mënyrë të papritur trajneri shqiptari ka pranuar ofertën që i ka ardhur nga Arabia Saudite duke firmosur për një sezon me skuadrën e Al Raed. Klubi saudit i cili nuk është një ekip me shumë emër në kampionatin arab ka zyrtarizuar marrëveshjen me Hasin. Një ndikim të madh në

kalimin e gjakovarit në Arabinë Saudite ka patur kompania "Star Sports Managment". Al Raed që sezonin e fundit e mbylli në vendin e 13-të, ka zgjedhur Hasin për t'u rikthyer në nivelet më të larta të futbollit arabo-saudit. Për 46-vjeçarin kjo do të jetë eksperiencia e katërt si trajner pas përvojave te Anderlecht ku fitoi një kampionat dhe një Superkupë të Belgjikë, Legian e Varshavës dhe Olympiacos.

FJALËKRYQESH

NGA KADRI VOKOPOLA



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 39 KUTI

17x17 grid for crossword puzzle 'Fjalëkryqi pa skemë'

HORIZONTAL

- 1. Ekstremit në sirtar. -Uncle... i Familja Addams -Parashtesë për dy. -Farrow aktor

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

Answers for 'Fjalëkryqi pa skemë' crossword

- 12. Eshhtë mbrojta e palëvishme. -Ishte i largët me cowboys. -Ente Autonome -Fillojnë misteret.

FJALËKRYQI SPORTIV

17x17 grid for crossword puzzle 'Fjalëkryqi sportiv'

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

Answers for 'Fjalëkryqi sportiv' crossword

HORIZONTAL

- 1. Mbaron në finish 5. Bizi ish-futbollist 11. Rita këngëtare

- 30. Conte trainer 32. Leoni aktore 33. Ka rivalë Mediaset

VERTIKAL

- 1. Një top në rrjetë 2. Mbyllin një sirtar 3. Mudn të jetë shënimi

SUDOKU

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo rresht e kolonë të ketë numrat nga 1-9

9x9 Sudoku grid

PËRGJIGJE

9x9 Sudoku grid with numbers

HOROSKOPI

DASHI



Fokusohuni në gjithçka, me qëllim arritjen e një objektivit të ri profesional, i cili mund të sjellë një sërë avantazhesh dhe kënaqësis.

DEMI



Shmangni tensionet dhe përplasjet e kota me bashkëpunëtorët tuaj. Kjo fundjavë do të jetë e rëndësishme për rigjetjen e sigurisë dhe stabilitetit në dashuri.

BINJAKËT



Kjo e enjte është mjaft e favorshme për të kultivuar dashurinë dhe ndjenjat. Edhe në vendin e punës do të jeni shumë aktiv dhe të përqendruar.

GAFORRJA



Nga pikëpamja sentimentale po çoni përpara një rikuperim të ndjeshëm, ndërsa sa i takon profesionit ndjeni nevojën për të gjetur një ekuilibër të ri.

LUANI



Mos e teproni në raport me disa vonesa të vogla në vendin e punës, pasi gjithsesi do të keni një intuitë të mirë, e cila do ju lejojë që të keni bashkëpunime të frytshme dhe të shmangni çdo problematikë.

VIRGJËRESHA



Kjo e enjte është mjaft interesante për të marrë pjesë në takime të reja për punën, të cilat do ju lejojnë që të merrni stimuj të rëndësishëm për realizimin e një projekti të ri.

PESHORJA



Ka disa propozime të rëndësishme, të cilat duhet të merrni në konsideratë, para se të nisni projekte të reja. Do të shfaqni një sjellje shumë pozitive, dhe mos hezitoni që të shprehni hapur në raport me kolegët tuaj.

AKREPI



Kjo e enjte është një periudhë mjaft e rëndësishme, për lidhjet në çift. Më në fund do të keni mënyrë që të thelloni disa raporte si dhe të përfshihen në aventura të reja romantike.

SHIGJETARI



Përfitoni nga kjo fundjavë për të kaluar më shumë kohë cilësore bashkë me familjen dhe partnerin/en tuaj. Në dashuri mos u tregoni shumë të nxituar, por kërkonti vëmendjen e shpirtit tuaj binjak, pasi ky është një moment shumë i favorshëm për emocionet.

BRICJAPI



Parashikohen ndryshime dhe të reja interesante në vendin tuaj të punës, por duhet të jeni të gatshëm që të pranoni edhe ndonjë kompromis me shumë. Nga pikëpamja emocionale, ky është një moment i mirë për të planifikuar aktivitetet e reja në çift.

UJORI



Sfera emocionale për ju, ka qenë gjithmonë shumë e rëndësishme dhe në këtë moment do të ndiheni mjaft të kënaqur. Keni punuar fortë, ndaj është momenti që të pushoni dhe ti kushtoni më shumë kohë vetes dhe ndjenjave tuaja.

PESHQIT



Ka disa konflikte të cilat duhet ti zgjidhni me partnerin/en, lidhur me disa punë që keni lënë në mes. Gjatë kësaj të enjteje, duhet të përpiqeni që të jeni më të hapur për dialog. Propozime të mira, janë fare pranë.

PËRGJIGJE

Answers for 'Shkronja e njëjtë për numër të njëjtë' crossword

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

17x17 grid for cryptogram crossword

Aktivisti i njohur, Adem Demaçi ka ndërruar jetë në moshën 82-vjeçare. Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti, ka bërë të ditur lajmin dje gjatë seancës plenare, teksa po diskutohej dialogu Kosovë-Serbi. "Ka ndërruar jetë mësuesi jonë, njeriu që i dha 28 vjet të jetës së tij nëpër kazamatet serbe. Ai ka ndërruar jetë, por vepra e tij do të lartësohet e të kujtohet për sa të ketë jetë" tha Xhavit Haliti. Kuvendi i Kosovës ka mbajtur një minutë heshtje në nderim të Demaçit.

JETA DHE VEPRA E ADEM DEMAÇIT

Adem Demaçi u lind në 1935, por zyrtarisht babai i tij Zeqiri e regjistroi më 26. 02. 1936. Që pas mbarimit të shkollës Demaçi u bw pjesw e organizatave që dënonin shpërnguljen masive nën dhunë të shqiptarëve për në Turqi dhe diskriminimin e tyre në çdo hap. Aktivisti dënonte fushatën e ashtuquajtur të mbledhjes së armëve që ishte ushtruar në dimrin e 1955 – 1956, dhe arrestimin e dënimin e grupit të studentëve me në krye Rexhep Latifin dhe Nysret Novakazin në Prishtinë dhe grupin e Burhan Pashollit në Shkup, sepse këto terrorizma frikësonin edhe më shumë turmat shqiptare dhe bënin që edhe më shumë të merrte hov shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi. Në pranverën e vitit 1958, në revistën letrare me emër "Jeta e re" falë guximit dhe përkujdesjes së poetit Esad Mekuli, në dy numra rrjesht u botua romani i Adem Demaçi "Gjarprinjt e gjakut".

Romani, nën petkun letrar, me



Ndahet nga jeta në moshën 82-vjeçare Adem Demaçi

Aktivisti i çështjes kombëtare vuajti 28 vite në burgjet serbe, Demaçi njihet si simbol i përpjekjeve për bashkimin Shqipëri-Kosovë

aludime dhe metafora pothuaj të hapta ishte në të vërtetë një mesazh politik. Porosi ishte që shqiptarët t'i lenin më një anë meritë dhe ngatërresat me njeri tjerin dhe krejt energjitë e tyre t'i drejtonin kundër pushtuesit. Menjëherë pas këtij botimi popullariteti i Ademit u rrit jashtë mase dhe emri i tij filloi të përmendej me dyshim të madh nëpër zyrat e policisë sekrete serbe.

Më 19. 11. 1958, në Prishtinë, "në emër të popullit" Adem Demaçi u arrestua nga qeveria autoritare e Josip Broz Tito dhe pas disa muajsh në hetuesi, doli para Gjyqit të Qarkut nën akuzën se ka bërë delikt politik, i inkriminuar si "propagandë armiqësore". Por në gjyq Ademi jo vetëm që nuk u mbrojti por u hodh në kundërsulm, duke u shprehur që Kosova duhet të shkëputej nga pushtimi jugosllav dhe të bashkohet me Shqipërinë. Demaçi u burgos për tri vite. Në vitin 1964 u burgos sërish deri në vitin 1974, dhe nga 1975-1990, kur u lirua nga burgu pas zhvillimeve demokratike në RFSJ. Për gati 29 vite, në burgjet e ish-Jugosllavisë, Adem Demaçi u përballë me të gjitha të këqijat që i vinin nga okupuesi e nga servilet e okupuesit për ta larguar nga rruga e tij e drejt madje goftë edhe për një periudhë të shkurtër. "Mandela i Kosovës" është nderuar me çmimet: "Urdhëri hero i Kosovës" në vitin 2010. Çmimi Saharov për Lirinë e Mendimit, 1991. Çmimi për të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Oslos, 1995

Shkrimtari Selatin Novosella i dedikoi edhe një libër këtij njeriu të pavdekshëm me titull "Demaçi-njeri i lavdisë".

REAGIMET

KADARE: TË TRONDITUR SI RRALLËHERË, MIKU YNË I PAZËVENDËSUESHËM

Pas vdekjes së aktivistit Adem Demaçi, ka reaguar dhe shkrimtari më i famshëm shqiptar, Ismail Kadare. Në një letër dërguar familjes, Çifti Helena dhe Ismail Kadare, i kanë shprehur ngushëllimet e tyre familjes, ku thonë se ndihen të tronditur si rrallëherë në jetë. "Te tronditur si rralle here ne jete, ju dergojme ngushellimet tona per humbjen e Ademit te shtrenjte, mikut te pazevendesueshem, te domosdoshem si rrallekush per ne dhe per kombin, Ismail dhe Helena Kadare." -thuhet në letrën e shpërndarë në media.

PRESIDENTI META: JAM I HIDHËRUAR, FRYMËZIM PËR BREZAT

Presidenti Ilir Meta ka reaguar pas lajmit për ndarjen nga jeta të aktivistit Adem Demaçi. Meta thotë se lajmi për ndarjen nga jeta të Adem Demaçin pikëllon të gjithë shqiptarët, si simboli i rezistencës kombëtare. "Jam thellësisht i hidhëruar nga lajmi i

ndarjes nga jeta të emblems së qëndresës shqiptare, Adem Demaçi. Kosova dhe mbarë shqiptarët përjetojnë sot me dhimbje të thellë humbjen e simbolit të rezistencës kombëtare, të luftës për liri dhe të një prej personaliteteve më të vlerësuara në arenën botërore. Duke u nderuar me çmimin "Sakharov" nga Parlamenti Evropian, kauza e madhe e luftës për një Kosovë të lirë fitoi përmasat e një çështjeje ndërkombëtare të shtruar për zgjidhje. Patrioti Adem Demaçi mbetet frymëzim për të gjitha brezat e shqiptarëve, një shembull dhe një model kombëtar i skalitur në historinë e shqiptarëve dhe të luftës kombëtare për pavarësinë e Kosovës. Sot humbëm atdhetarin e flaktë, njeriun që mbajti gjallë shpresën e së ardhmes dhe idealin e pavarësisë së Kosovës. I përjetshëm goftë kujtimi dhe vepra e tij!"

RAMA: BURRË I LLOJIT MË TË VEÇANTË, IKU SI ZOTNI E I THA TË GJITHA

Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas ndarjes nga jeta të aktivistit Adem Demaçi. Në



një reagim në rrjetet sociale, Rama shkruan se me vdekjen e tij mbyllet historia e një rebeli të rrallë. "Me vdekjen e Adem Demaçit mbyllet historia e jashtëzakonshme e një rebeli të llojit më të rrallë: shqiptar i llojit më të mirë, burrë i llojit më të veçantë, mik i llojit më të lartë. Pas një jete prej stuhie pambarim, ai u tret ngadalë e iku si zotnia që i tha të gjitha #RESPEKT"-shkruan Rama.

PD MESAZH NGUSHËLLIMI, BASHA: HUMBJE E MADHE

Partia Demokratike dhe kryetari Lulzim Basha, kanë ngushëlluar familjen e aktivistit Adem Demaçi, pas lajmit për ndarjen e tij nga jeta. Në mesazhin e Bashës thuhet se kombi shqiptar humbi një nga njerëzit që ka

mbajtur peshën e krenarisë kombëtare. "Me hidhërim mësova lajmin e ndarjes nga jeta të Adem Demaçit, Mandelës së Kosovës. Sot gjithë kombi mban zi sepse humbi një ndër njerëzit që me sakrificën, fisnikërinë dhe mendimin e tyre përbëjnë shtylla që mbajnë peshën e krenarisë kombëtare. Në emrin tim dhe të Partisë Demokratike u shpreh ngushëllimet më të ndjera familjes Demaçi, miqve dhe bashkëpunëtorëve të tij dhe gjithë popullit të Kosovës, për këtë humbje të madhe. Adem Demaçi si një ndër simbolet e qëndresës kombëtare, mbetet përherë në kujtesën e kombit që përkulet me mirënjohje të thellë para sakrificës dhe kontributit të tij të pavdekshëm për Kosovën" thotë Basha.

VETËVENDOSJA: SHQIPTARËT, TË PIKËLLUAR, S'U DORËZUA KURRË

Reagime të shumta kanë nisur pas lajmit për ndarjen nga jeta të aktivistit Adem Demaçi, të njohur për çështjet kombëtare. Lëvizja Vetëvendosje i ka dërguar një mesazh ngushëllimi familjes, ku thekson se veprimtaria e Demaçit do të mbahet mend, bashkë me flakën e atdhetarisë që ndezi në zemrat e shqiptarëve.

"Ngushëllime popullit shqiptar dhe lirinësve të gjithë botës. Vdekja e Adem Demaçit pikëllon rëndë gjithë shqiptarët, e në fakt gjithë lirinësve. Në këto momente dëshirojmë t'i gjendemi pranë sidomos familjarëve e të afërmeve të familjes Demaçi. Veprimtari i cili kurrë nuk u dorëzua e nuk u thye, as prej dekadave të burgut, sot nuk është më mes nesh. Por më e pranishme se kurrë është flaka e atdhetarisë, ideali që ai ndezi në zemrat tona. Nuk ka aktivist të Lëvizjes që nuk është edukuar në frymën dhe në shembullin e

Adem Demaçit, i cili ka qenë dhe do të jetë përgjithmonë busulla dhe fari, jo vetëm për Lëvizjen VETËVENDOSJE!, por për çdo subjekt të sotëm apo të ardhshëm që synon emancipimin e popullit tonë. Adem Demaçi mishëronte si askush tjetër të gjitha virtytet e tiparet e veprimtarit që nuk reshti asnjëherë së preokupuari e angazhuari për popullin e kombin. Fjalët nuk gjenden për ta përshkruar angazhimin e tij që mbetet një simbol i pashlyer, e dhembjen e madhe, por vepra e tij monumentale do të përndritë gjithmonë shqiptarët, e shembulli i tij do të frymëzojë të gjithë ata që kombin dhe atdheun e vënë mbi vetën e gjithcka tjetër. Adem Demaçi vdiq, por ai është i pavdekshëm. Vigan në panteonin e kombit, me shpirtin e tij të fortë, me parimet e tij të panegociueshme, me vlerat e tij njerëzore e universale, ai e mposhti çdo gjakatar e çdo tiran. Qëndresa e tij do të mbetet frymëzim, vepra e tij do të jetë mësimi ynë. Je i përjetshëm në zemrat e shqiptarëve, baca Adem!" thuhet në njoftimin e Vetëvendosjes.